

Ligji i datës 01 Prill 1981, nr. 121

Botuar në Gazetën Zyrtare të datës 10 prill 1981, nr. 100.

Rregullorja e re në Administratën e sigurisë publike.

KREU I - Administrata e sigurisë publike dhe bashkërendimi i forcave të policisë.

Neni 1. Kompetencat e Ministrit të Brendshëm

1. Ministri i Brendshëm është përgjegjës për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe është autoriteti kombëtar i sigurisë publike. Ka drejtimin e lartë të shërbimeve të rendit publik dhe bashkërendon në këtë fushë detyrat dhe veprimtaritë e forcave të policisë.
2. Ministri i Brendshëm merr masat për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike.
3. Mbeten të pandryshuara kompetencat e Këshillit të Ministrave të parashikuara nga ligjet në fuqi për Administratën e sigurisë publike dhe administrimin e forcave të policisë.

Neni 2. Mbrojtja e rendit dhe e sigurisë publike

1. Ministri i Brendshëm i kryen detyrat e veta në fushën e mbrojtjes së rendit dhe të sigurisë publike duke shfrytëzuar Administratën e sigurisë publike.

Neni 3. Administrata e sigurisë publike

1. Administrata e sigurisë publike është civile dhe ka një rregullore të veçantë.
2. Funkcionet e saj ushtrohen:
 - a) nga personeli i ngarkuar i zyrave të departamentit të sigurisë publike dhe i zyrave të tjera, i instituteve dhe i reparteve nga të cilat përbëhet ajo vetë;
 - b) nga autoritetet provinciale, nga personeli që varet prej tyre, si edhe nga autoritetet vendore të sigurisë publike;
 - c) nga oficerët dhe nga agjentët e sigurisë publike nën drejtimin e autoriteteve qendrore dhe provinciale të sigurisë publike.

Neni 4. Departamenti i sigurisë publike

1. Në kuadrin e Administratës së sigurisë publike është krijuar departamenti i sigurisë publike, i cili merr masa, sipas direktivave dhe urdhrave të Ministrit të Brendshëm:
 - 1) me zbatimin e politikës së rendit dhe të sigurisë publike;
 - 2) me bashkërendimin tekniko-operativ të forcave të policisë;
 - 3) me drejtimin dhe me administrimin e Policisë së Shtetit;
 - 4) me drejtimin dhe menaxhimin e suporteve teknike, edhe për nevojat e përgjithshme të Ministrisë së Brendshme.

Neni 5. Organizimi i departamentit të sigurisë publike

1. Departamenti i sigurisë publike ndahet në zyrat dhe drejtoritë e përgjithshme si më poshtë vijojnë:
 - a) zyra për bashkërendimin dhe planifikimin, sikurse parashikohet në nenin 6;
 - b) zyra qendrore inspektuese;
 - c) drejtoria qendrore e policisë kriminale;
 - d) drejtoria qendrore për çështjet e përgjithshme;
 - e) drejtoria qendrore e policisë së parandalimit;
 - f) drejtoria qendrore për policinë rrugore, hekurudhore, kufitare dhe postare;
 - g) drejtoria qendrore e personelit;
 - h) drejtoria qendrore për institutet e hetimeve;
 - i) drejtoria qendrore e shërbimeve tekniko-logjistike dhe të menaxhimit të pasurisë;
 - l) drejtoria qendrore për shërbimet e kontabilitetit.

l-bis) drejtoria qendrore e shëndetësisë, në krye të së cilës ndodhet drejtuesi i përgjithshëm mjek i pozicionit profesional shëndetësor të Policisë së Shtetit.
2. Departamenti drejtohet nga shefi i policisë-drejtori i përgjithshëm i sigurisë publike, i emëruar me vendim të Presidentit të Republikës, mbas vendimit të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm.

3. Shefit të policisë-drejtorit të përgjithshëm të sigurisë publike i është caktuar një pension i posaçëm, masa e të cilit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin e Thesarit. Me të njëjtat mënyra veprohet edhe për Komandantin e Përgjithshëm të Armës së Karabinierëve, për Komandantin e Përgjithshëm të Policisë Tatimore (Guardia di Finanza), për Drejtorin e Përgjithshëm për institutet e parandalimit dhe të dënimit dhe për Drejtorin e Përgjithshëm për ekonominë malore dhe për pyjet.

4. Në departament janë emëruar dy zëvendës drejtorë të përgjithshëm, njëri prej të cilëve për kryerjen e funksioneve përfaqësuese, ndërsa tjetri për veprimtarinë e bashkërendimit dhe të planifikimit.

5. Zëvendës drejtori i përgjithshëm i sigurisë publike me funksionet përfaqësuese parazgjidhet ndër prefektët që vijnë nga pozicionet e Policisë së Shtetit.

6. Zyra qendrore inspektuese, me kërkesën e Ministrit ose të drejtorit të përgjithshëm, ka për detyrë që të verifikojë zbatimin e urdhrave dhe të direktivave të Ministrit dhe të drejtorit të përgjithshëm;

të raportojë në lidhje me veprimtarinë e zhvilluara nga ana e zyrave dhe e organeve periferike të Administratës së sigurisë publike; të verifikojë efikasitetin e shërbimeve dhe menaxhimin me korrektësi të pasurisë dhe të kontabilitetit.

Përcaktimi i numrit të kompetencave të zyrave, të shërbimeve dhe të divizioneve në të cilat ndahet Departamenti i sigurisë publike, si edhe përcaktimi i organikave dhe i mjeteve në dispozicion kryhen me vendim të Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin e Thesarit.

7. Për drejtimin e zyrave dhe të drejtorive qendrore janë caktuar drejtuesit e përgjithshëm.

8. Në drejtorinë qendrore për shërbimet e kontabilitetit mund të caktohet një drejtues i përgjithshëm i kontabilitetit i Administratës civile të punëve të brendshme.

Neni 6. Bashkërendimi dhe drejtimi njësor i forcave të policisë

1. Departamenti i sigurisë publike, me qëllim që të zbatojë direktivat e dhëna nga ana e Ministrit të Brendshëm në ushtrimin e kompetencave të bashkërendimit dhe të drejtimit njësor në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, kryen detyrat e:

a) klasifikimit, analizës dhe të vlerësimit të informacioneve dhe të të dhënave që duhet të jepen edhe nga forcat e policisë në fushën e mbrojtjes së rendit, të sigurisë publike dhe të parandalimit dhe të shtypjes së kriminalitetit dhe të përhapjes së tyre pranë organeve operative të forcave të policisë të sipërpërmendura;

b) kërkimit shkencor dhe teknologjik, dokumentacionit, studimit dhe statistikës;

c) përpunimit të planifikimit të përgjithshëm të shërbimeve të rendit dhe të sigurisë publike;

d) planifikimit të përgjithshëm dhe bashkërendimit të planifikimeve operative të shërbimeve logjistike dhe administrative me karakter të zakonshëm për forcat e policisë;

e) planifikimit të përgjithshëm dhe bashkërendimit të planifikimeve operative të vendosjes së forcave të policisë dhe të shërbimeve teknike përkatëse;

f) planifikimit të përgjithshëm dhe bashkërendimit të planifikimeve financiare në lidhje me forcat e veçanta të policisë;

g) mbajtjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve me vendet e Bashkimit Europian dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

2. Për zbatimin e funksioneve të sipërpërmendura, caktohet, sipas kriterëve të kompetencës tekniko-profesionale, personel që i përket pozicioneve të Policisë së Shtetit dhe pozicioneve të Administratës civile të punëve të brendshme, sipas kontigjenteve të përcaktuara me vendim të Ministrit të Brendshëm, si edhe personel i forcave të tjera të policisë dhe i administratave të tjera të Shtetit, sipas kontigjenteve të përcaktuara me vendim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin e Thesarit dhe me Ministrat e interesuar.

3. Për zbatimin e detyrave të veçanta shkencore dhe teknike, mund t'u jepen detyra edhe atyre që nuk i përkasin administratës publike.
4. Detyrat jepen për një kohë të caktuar, me vendim të Ministrit të Brendshëm, mbasi të jetë dëgjuar mendimi i Këshillit Administrativ dhe nuk mund ta kapërcejnë vitin financiar; mund të ripërtërihen për jo më shumë se dy herë.
5. Në tërësi nuk mund t'i besohen të njëjtit person të ngarkuar studime që kanë të bëjnë me një apo më shumë administrata ose shërbime për një periudhë më të gjatë se tre vite financiare, ciladoqoftë fusha që përbën objektin e detyrës së ngarkuar. Sidoqoftë përjashtohet bashkimi i detyrave të ngarkuara në të njëjtin vit financiar, edhe pse duhet të kryhen për llogari të administratave të ndryshme.
6. Për respektimin e kufijve të sipërpërmendur, i ngarkuari është i detyruar që të deklarojë me shkrim, nën përgjegjësinë e tij personale, se ndaj tij nuk ekziston asnjëra prej hipotezave të përcaktuara nga paragrafi i mëparshëm.
7. Caktimi i detyrës varet, gjithashtu, nga një leje e posaçme e lëshuar nga administratës së cilës i përket i ngarkuari, në rastet kur bëhet fjalë për punonjës publik.
8. Shpërblimi përcaktohet, në lidhje me rëndësinë dhe me kohëzgjatjen e detyrës së ngarkuar, me vendim të Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin e Thesarit.

Neni 7. Natyra dhe masa e të dhënave dhe e informacioneve të mbledhura

1. Informacionet dhe të dhënat sikurse parashikohet më sipër në nenin 6, shkronja a), duhet t'u referohen njoftimeve që rezultojnë nga dokumente që sidoqoftë ruhen nga administrata shtetërore ose nga entet publike, ose që rezultojnë nga vendimet apo nga masat e marra nga autoriteti gjyqësor ose nga akte që kanë të bëjnë me hetimin penal, të cilat janë administruar në mbështetje të nenit 165-ter të kodit të procedurës penale pse nga hetimet e policisë.
2. Në çdo rast, ndalohet të mblidhen informacione dhe të dhëna në lidhje me shtetasit për të vetmin fakt që ka të bëjë me racën e tyre, me besimin fetar ose opinionin politik, ose për përkrahjen nga ana e tyre të parimeve të lëvizjeve sindikaliste, kooperative, asistenciale, kulturore, si edhe për veprimtarinë e ligjshme që kryejnë në kuadrin e përkatësisë së tyre në organizata të cilat ushtrojnë veprimtari të ligjshme në sektorët e sipërpërmendur.
3. Mund të administrohen informacione që kanë lidhje me operacione apo pozicione bankare në kufijtë e kërkuar nga hetimet e policisë gjyqësore dhe me mandat të shprehur nga ana e autoritetit gjyqësor, pa u kundërvënë sekreti nga ana e organeve përgjegjëse të ndërmarrjeve të kreditit ose të instituteve të kreditit (bankave) të së drejtës publike.
4. Mund të administrohen, gjithashtu, edhe informacionet dhe të dhënat sikurse më sipër në nenin 6, të cilat zotërohen nga policitë e Shteteve që i përkasin Komunitetit Ekonomik Europian dhe të atyre kufitare, si edhe në çdo shtet tjetër, me të cilin janë lidhur marrëdhënie spevifike në këtë kuptim.
5. Mund t'u komunikohen, gjithashtu, policive të përmendura në paragrafin e mëparshëm informacionet dhe të dhënat sikurse më sipër në nenin 6, që nuk janë të mbuluara nga sekreti hetimor.

Neni 8. Institucioni i Qendrës së përpunimit të të dhënave

1. Është krijuar pranë Ministrisë së Brendshme, në kuadrin e zyrës sikurse parashikohet në shkronjën c) të paragrafit të parë të nenit 5, Qendra e përpunimit të të dhënave, për mbledhjen e informacioneve dhe të të dhënave parashikohet më sipër në nenin 6, shkronja a), si edhe në nenin 7.
2. Qendra merret me mbledhjen, përpunimin, klasifikimin dhe ruajtjen në arkivat magnetike të informacioneve dhe të të dhënave, si edhe me komunikimin e tyre subjekteve të autorizuar, sikurse janë treguar në nenin 9, sipas kritereve dhe normave teknike që janë përcaktuar në mbështetje të paragrafit vijues.
3. Me vendim të Ministrit të Brendshëm është krijuar një komision teknik, i cili drejtohet nga funksionari që drejton zyrën sikurse parashikohet në shkronjën c) të paragrafit të parë të nenit 5,

për caktimin e kriterëve dhe të normave teknike për kryerjen nga ana e Qendrës të operacioneve sikurse parashikohet në paragrafin e mëparshëm dhe për kontrollin teknik në lidhje me respektimin e këtyre kriterëve dhe normave nga ana e personelin që punon pranë vetë kësaj Qendre. Kriteret dhe normat teknike të sipërpërmendura bëhen të zbatueshme me miratimin nga ana e Ministrisë të Brendshme.

4. [Çdo administratë, ent, ndërmarrje, shoqatë apo subjekt privat që për çfarëdolloj qëllimi formon ose mban arkiva magnetike, në të cilat futen të dhëna ose informacione të çfarëdolloj natyre, në lidhje me shtetasit italianë, është e detyruar që të njoftojë për ekzistencën e këtij arkivi Ministrinë e Brendshme brenda datës 31 dhjetor 1981 ose, sidoqoftë, brenda datës 31 dhjetor të vitit në të cilin është instaluar arkivi ose ka filluar aktivizimi i tij. Brenda datës 31 dhjetor 1982 Qeveria do të informojë Parlamentin për elementët e mbledhur në këtë mënyrë, me qëllim që të bëhet çdo përcaktim i duhur legjislativ në mbrojtje të së drejtës së ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave të shtetasve. Zotëruesi ose përgjegjësi i arkivit magnetik që nuk e kryen këtë njoftim, dënohet me gjobë në masën nga treqind mijë deri në tre milionë Lira italiane].

Neni 9. Aksesit në të dhënat dhe në informacionet dhe përdorimi i tyre.

1. Aksesit në të dhënat dhe në informacionet që ruhen në arkivat e automatizuara nga Qendra e përmendur në nenin e mësipërm dhe përdorimi i tyre u lejohet oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët i përkasin forcave të policisë, oficerëve të sigurisë publike dhe funksionarëve të shërbimeve të sigurisë, si edhe agjentëve të policisë gjyqësore të forcave të policisë të autorizuar siç duhet, në mbështetje të paragrafit të dytë të nenit të mëposhtëm 11.

2. Aksesit në të dhënat dhe në informacionet sikurse parashikohet në paragrafin e mëparshëm i lejohet autoritetit gjyqësor, për qëllimet e verifikimeve të nevojshme në lidhje me procedimet në vazhdim dhe në kufijtë e përcaktuar nga kodi i procedurës penale.

3. Sidoqoftë, ndalohet çfarëdolloj përdorimi i i informacioneve dhe i të dhënave të sipërpërmendura për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 6, shkronja a). Ndalohet, gjithashtu, çdo qarkullim i informacioneve brenda administratës publike jashtë rasteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni.

4. [Asnjë vendim gjyqësor që sjell për pasojë vlerësime të sjelljeve nuk mund të mbështetet ekskluzivisht mbi përpunimet automatike të informacioneve që japin një profil të personalitetit të të interesuarit].

Neni 10. Kontrolli

1. Kontrolli mbi Qendrën e përpunimit të të dhënave ushtrohet nga Garanti për mbrojtjen e të dhënave personale, me mënyrat e parashikuara në ligji dhe nga rregulloret.

2. Të dhënat dhe informacionet e ruajtura në arkivat e Qendrës mund të përdoren në procedimet gjyqësore ose administrative vetëm nëpërmjet administrimit të burimeve të origjinës të treguara në paragrafin e parë të nenit 7, pa ndryshuar gjithë sa është përcaktuar nga neni 240 i kodit të procedurës penale. Atëherë kur gjatë zhvillimit të një procedimi juridiksional ose administrativ zbulohet gabimi ose paplotësia e të dhënave dhe e informacioneve, ose kundërligjshmëria e trajtimit të tyre, autoriteti procedues njofton në lidhje me sa më sipër Garantin, për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Personi, të cilit i referohen të dhënat, mund t'i kërkojë zyrës sikurse parashikohet në shkronjën c) të paragrafit të parë të nenit 5, konfirmimin e ekzistencës së të dhënave personale që i përkasin atij vetë, komunikimin e tyre në formë të kuptueshme dhe, në qoftë se të dhënat rezultojnë të jenë trajtuar në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi ose të rregullores, fshirjen e tyre ose shndërrimin në formë anonime.

4. Mbasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme, zyra i komunikon kërkuesit, jo më tej se tridhjetë ditë nga kërkesa, vendimet e marra. Zyra mund të mos marrë masa në lidhje me kërkesën, në qoftë se kjo mund të paragjykojë veprime apo operacione që kryhen në mbrojtje të

sigurisë publike ose për parandalimin dhe shtypjen e kriminalitetit, duke i dhënë informacione Garantit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Kushdo që merr dijeni për ekzistencën e të dhënave personale që i takojnë atij vetë, të cilat janë trajtuar edhe në formë jo të automatizuar në shkelje të dispozitave ligjore ose të rregullores, mund t'i kërkojë gjykatës së vendit ku e ka vendbanimin titullari i trajtimit, që të kryejë verifikimet e nevojshme dhe të urdhërojë ndreqjen, plotësimin, fshirjen ose shndërrimin në formë anonime të vetë të dhënave.

Neni 11. Procedurat

1. Nëpërmjet rregullores, e cila duhet të shpallet brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me vendim të Presidentit të Republikës, mbas vendimit të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin e Drejtësisë, janë përcaktuar procedurat për mbledhjen e të dhënave dhe të informacioneve sikurse parashikohet në nenin 6, shkronja a), s edhe në nenin 7, për aksesin dhe komunikimin e vetë të dhënave subjekteve ta parashikuara nga neni 9, si edhe për korigjimin ose fshirjen e të dhënave të gabuara dhe për plotësimin e atyre jo të plota.

2. Një regjim i veçantë autorizimesh nga ana e drejtuesve të zyrave dhe shërbimeve përkatëse, atëherë kur nuk e bëjnë këta kërkesën e drejtpërdrejtë të të dhënave dhe të informacioneve, duhet të parashikohet nga rregullorja për subjektet e treguara në paragrafin e parë të nenit 9.

Neni 12. Sanksionet

1. Funksonari publik që komunikon ose përdor të dhënat dhe informacionet në shkelje të dispozitave të këtij ligji, ose jashtë qëllimeve të parashikuara prej vetë këtij ligji, dënohet, përveç rastit kur fakti përbën një vepër penale më të rëndë, me burgim nga një deri në tre vjet. Në qoftë se fakti është kryer me faj, dënimi është me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 13. Prefekti

1. Prefekti është autoriteti provincial i sigurisë publike .

2. Prefekti ka përgjegjësinë e përgjithshme të rendit dhe të sigurisë publike në provincë dhe mbikëqyr zbatimin e direktivave të shpallura në këtë fushë.

Siguron unitetin e drejtimit dhe të bashkërendimit të detyrave dhe të veprimtarive të oficerëve dhe të agjentëve të sigurisë publike në provincë, duke promovuar masat e nevojshme.

3. Për këto qëllime, prefekti duhet të informohet në kohën e duhur nga kuestori dhe nga komandantët provincialë të Armës së Karabinierëve dhe të Policisë Tatimore (Guardia di Finanza) mbi gjithçka që, sidoqoftë, ka të bëjë me rendin dhe me sigurinë publike në provincë.

4. Prefekti disponon forcën publike dhe forcat e tjera që mund të jenë vënë në dispozicionin e tij në bazë të ligjeve në fuqi dhe bashkërendon veprimtaritë e tyre.

5. Prefekti i përcjell Ministrit të Brendshëm relacione mbi veprimtarinë e forcave të policisë duke iu referuar detyrave të parashikuara në këtë nen.

6. Prefekti informon komisararin e Qeverisë në qark në lidhje me masat që merr në kuadrin e të drejtave që i janë caktuar atij nga ky ligj.

Neni 14. Kuestori

1. Kuestori është autoriteti provincial i sigurisë publike .

2. Kuestori ka drejtimin, përgjegjësinë dhe bashkërendimin, në nivel tekniko-operativ, të shërbimeve të rendit dhe të sigurisë publike dhe të përdorimit, për këtë qëllim, të forcës publike dhe të forcave të tjera që mund të jenë vënë në dispozicionin e tij.

3. Për këtë qëllim, duhet të informohet në kohën e duhur nga komandantët vendorë të Armës së Karabinierëve dhe të Policisë Tatimore (Guardia di Finanza) mbi gjithçka që, sidoqoftë, ka të bëjë me rendin dhe me sigurinë publike.

Neni 15. Autoritetet vendore të sigurisë publike

1. Janë autoritete vendore të sigurisë publike kuestori në kryeqendrën e provincës dhe funksionarët e caktuar në krye të komisariateve të policisë që kanë kompetenca në komunat e tjera.

2. Në rast se nuk janë krijuar komisariatet e policisë, kompetenat e autoritetit vendor të sigurisë publike ushtrohen nga kryetari i bashkisë, si funksionar i Qeverisë.

3. Kur e kërkojnë nevoja të jashtëzakonshme shërbimi, prefekti, ose kuestori me autorizimin e prefektit, mund të dërgojë funksionarë të Policisë së Shtetit, në komunat sikurse parashikohet në paragrafin e mëparshëm, për të marrë përsipër përkohësisht drejtimin e shërbimeve të sigurisë publike. Në një rast të tillë mbetet e pezulluar kompetenca e autoritetit vendor të sigurisë publike.

4. Autoritetet provinciale të sigurisë publike, për qëllimet e rendit dhe të sigurisë publike dhe të parandalimit dhe të mbrojtjes nga dhuna shkatërruese, nxisin bashkëpunimin e administratave vendore dhe mbajnë marrëdhënie me kryetarët e komunave.

Neni 16. Forcat e policisë

1. Për qëllimet e mbrojtjes së rendit dhe të sigurisë publike, përveç Policisë së Shtetit janë forcat e policisë, duke mbetur të pandryshuara rregulloret dhe vartësitë përkatëse:

a) Arma e Karabinierëve, si forcë e armatosur në shërbim të përhershëm të sigurisë publike ;

b) Trupa e Policisë Tatimore (Guardia di Finanza), për bashkëpunimin në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike .

2. Me përjashtim të kompetencave përkatëse dhe të normave të rregulloreve në fuqi, janë forca policie dhe mund të thirren për të bashkëpunuar në kryerjen e shërbimeve të rendit dhe të sigurisë publike, Trupa e agjentëve të rojes dhe Trupa pyjore e Shtetit.

3. Forcat e policisë mund të përdoren edhe për shërbimin e ndihmës publike.

Neni 17. Funksionet dhe shërbimet e policisë gjyqësore

1. Funksionet e policisë gjyqësore zhvillohen në vartësinë dhe nën drejtimin e autoritetit gjyqësor, në përputhje me sa është përcaktuar nga kodi i procedurës penale. Për këtë qëllim, departamenti i sigurisë publike merr masa, në kontigjentet e nevojshme, të përcaktuara nga ana e Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin e Drejtësisë, për krijimin dhe organizimin e shërbimeve të policisë gjyqësore edhe në bazët direktivave të shpallura nga Ministri i Brendshëm në kuadrin e ushtrimit të kompetencave të bashkërendimit.

Neni 18. Komiteti kombëtar i rendit dhe i sigurisë publike

1. Pranë Ministrisë së Brendshme është krijuar Komiteti kombëtar i rendit dhe i sigurisë publike, si organ ndihmës i këshillimit i Ministrin të Brendshëm për ushtrimin e kompetencave të tij të drejtimit të lartë dhe të bashkërendimit në fushën e rendit dhe të sigurisë publike .

2. Komiteti drejtohet nga Ministri i Brendshëm dhe përbëhet nga një Zëvendësministër Shteti për Punët e Brendshme, i caktuar nga Ministri, me funksionet e zëvendëskryetarit, nga shefi i policisë-drejtori i përgjithshëm i sigurisë publike, nga komandanti i përgjithshëm i Armës së Karabinierëve, nga komandanti i përgjithshëm i Trupës së Policisë Tatimore (Guardia di Finanza).

3. Në Komitet bën pjesë edhe drejtori i përgjithshëm i Administratës së burgjeve dhe drejtuesi i përgjithshëm i Trupës pyjore të Shtetit.

4. Ministri i Brendshëm mund të thërrasë për të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit drejtuesit e përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, inspektorin e përgjithshëm të Trupës së kapitenerive të porteve, si edhe përfaqësues të tjerë të administratës së Shtetit dhe të forcave të armatosura; mund të ftojë po në këto mbledhje edhe pjesëtarët e sistemit gjyqësor, në marrëveshje me prokurorin kompetent.

5. Një funksionar me kualifikim drejtues kryen funksionet e Sekretarit të Komitetit.

Neni 19. Kompetencat e Komitetit kombëtar

1. Komiteti merr në shqyrtim çdo çështje me karakter të përgjithshëm në lidhje me mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe me rregulloren dhe organizimin e forcave të policisë që i parashtrihen atij nga ana e Ministrin të Brendshëm.

2. Komiteti duhet të shprehet:

a) mbi skemt e masave me karakter të përgjithshëm që kanë të bëjnë me forcat e policisë;

- b) mbi planet për dhënien e kompetencave funksionale dhe territoriale forcave të policisë;
- c) mbi planifikimin financiar që ka të bëjë me forcat policisë;
- d) mbi planifikimin e shërbimeve logjistike dhe administrative me karakter të përbashkët për forcat e policisë;
- e) mbi planifikimin e vendosjes dhe të bashkërendimit të forcave të policisë dhe të shërbimeve të tyre teknike;
- f) mbi linjat e përgjithshme për arsimin, stërvitjen, formimin dhe specializimin e personelit të forcave të policisë.

Neni 20. Komiteti provincial për rendin dhe për sigurinë publike

1. Pranë prefekturës është krijuar komiteti provincial për rendin dhe sigurinë publike, si organ ndihmës i këshillimit të prefektit për ushtrimin e kompetencave të tij të autoritetit provincial të sigurisë publike .

2. Komiteti drejtohet nga prefekti dhe përbëhet nga kuestori, nga kryetari i bashkisë së kryeqendrës dhe nga kryetari i provincës, nga komandantët e Armës së Karabinierëve, të Trupës së Policisë Tatimore (Guardia di Finanza), si edhe të Trupës pyjore të Shtetit, si edhe nga kryetarët e komunave të tjera të interesuara, kur duhet të trajtohen çështje të cilat u referohen fushave territoriale përkatëse.

3. Për qëllimet e mbrojtjes së rendit dhe të sigurisë publike, si edhe të parandalimit të veprave penale, prefekti mund të thërrasë për të marrë pjesë në seancat e mbledhjeve të Komitetit autoritetet vendore të sigurisë publike dhe përgjegjësit e administratave të Shtetit që janë të interesuara për problemet që do të trajtohen, me vëmendje të veçantë ndaj përgjegjësve të zyrave kompetente të Administratës së burgjeve, të Trupës kombëtar të zjarrfikësve, të Trupës së kapitenerive të porteve, dhe, në marrëveshje me kryetarin e provincës ose me kryetarin e bashkisë, përgjegjësit e zyrave të tjera dhe të Administratave vendore të interesuara ose të policisë bashkiake.

4. Prefekti mund të ftojë po në këto mbledhje edhe pjesëtarët e sistemit gjyqësor, në marrëveshje me prokurorin e Republikës kompetent.

5. Me thirrjen dhe me hartimin e rendit të ditës së mbledhjes së komitetit merret prefekti. Thirrja vendoset, në çdo rast, kur e kërkon kryetari i bashkisë së kryeqendrës së provincës për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë e komunitetit vendor ose për parandalimin e tensioneve ose të konflikteteve shoqërore që mund të shkaktojnë për pasojë turbullime të rendit ose të sigurisë publike në kuadrin e bashkisë. Për trajtimin e po këtyre çështjeve, me kërkesën e kryetarit të bashkisë, atëherë kur nevojitet, plotësohet rendi i ditës i mbledhjes së komitetit.

Neni 21. Lidhjet dhe sallat operative të përbashkëta ndërmjet forcave të policisë

1. Ministri i Brendshëm, në ushtrimin e kompetencave të tij të bashkërendimit, jep direktiva dhe shpall masa për të përcaktuar lidhjet ndërmjet sallave operative të forcave të policisë dhe krijon, në raste nevojë të veçantë, me vendimin e vet dhe në marrëveshje me Ministrat e interesuar, salla operative të përbashkëta.

Neni 22. Shkolla e specializimit për forcat e policisë

1. Është krijuar, pranë departamentit të sigurisë publike, shkolla e specializimit për forcat e policisë.

2. Kurset e zhvilluara nga shkolla i drejtohen formimit të lartë dhe përditësimit të funksionarëve dhe të oficerëve të forcave të policisë, për një përgatitje të përshtatshme dhe të kualifikuar në lëndët që kanë të bëjnë me detyrat institucionale.

3. Frekuentimi dhe kalimi me rezultat të favorshëm i kurseve përbën një titull për ngritjen në karrierë.

4. Me anën e rregullores që duhet të shpallet me vendim të Presidentit të Republikës, mbas vendimit të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm, merren masa për përcaktimin e kriterëve dhe të mënyrave të pranimit në shkollë, të emërimit të pedagogëve dhe të zhvillimit të kurseve, si edhe për përcaktimin e strukturave dhe të rregullores së shkollës.

KREU II - Rregullorja e Administratës së sigurisë publike

Trupa erojeve të sigurisë publike dhe Trupa e policisë femërore janë shkrirë.

Personat që mbulojnë postet e personelit civil të karrierës drejtuese të sigurisë publike dhe ata që mbulojnë postet e trupave sikurse parashikohet në paragrafin e parë, bëjnë pjesë në Administratën e sigurisë publike, sipas mënyrave dhe në bazë të normave të inkuadrimit që janë treguar nga ky ligj dhe nga vendimet që do të shpallen në mbështetje të nenit 36.

Pozicionet e personelit për të cilin bëhet fjalë në paragrafin e mëparshëm, që kryen funksionet e policisë, ato të personelit që zhvillon veprimtari teknike ose shkencore që ka të bëjë me shërbimet e policisë, si edhe ato të personelit që zhvillon veprimtari me karakter profesional që ka të bëjë me shërbimet e policisë, sikurse parashikohet nga neni 36, marrin emërtimin e posteve të Policisë së Shtetit.

Trajtimi ekonomik diferencohet në mënyrë që të mbahen parasysh me përparësi veprimtaritë specifike institucionale që zhvillohen nga personeli që kryen funksionet e policisë kundrejt personelit që u përket posteve të tjera që bëjnë pjesë në Policinë e Shtetit.

Për personelin që u përket pozicioneve të Administratës së sigurisë publike, për sa nuk është parashikuar nga ky ligj, zbatohen, duke qenë në përputhje, normat që kanë të bëjnë me nëpunësit civilë të Shtetit.

Personeli që u përket pozicioneve të punëtorëve të përhershëm të shkollave të policisë dhe pozicionit të punëtorëve të magazinave të Trupës së rojeve të sigurisë publike, bën pjesë në pozicionet e Administratës civile të Punëve të Brendshme, sipas dispozitave të parashikuara nga neni 40 Rregullorja e Administratës së sigurisë publike.

Neni 23. Personeli i Administratës së sigurisë publike.

1. Trupa e rojeve të sigurisë publike dhe Trupa e policisë femërore janë shkrirë.

2. Personat që mbulojnë postet e personelit civil të karrierës drejtuese të sigurisë publike dhe ata që mbulojnë postet e trupave sikurse parashikohet në paragrafin e parë, bëjnë pjesë në Administratën e sigurisë publike, sipas mënyrave dhe në bazë të normave të inkuadrimit që janë treguar nga ky ligj dhe nga vendimet që do të shpallen në mbështetje të nenit 36.

3. Pozicionet e personelit për të cilin bëhet fjalë në paragrafin e mëparshëm, që kryen funksionet e policisë, ato të personelit që zhvillon veprimtari teknike ose shkencore që ka të bëjë me shërbimet e policisë, si edhe ato të personelit që zhvillon veprimtari me karakter profesional që ka të bëjë me shërbimet e policisë, sikurse parashikohet nga neni 36, marrin emërtimin e posteve të Policisë së Shtetit.

4. Trajtimi ekonomik diferencohet në mënyrë që të mbahen parasysh me përparësi veprimtaritë specifike institucionale që zhvillohen nga personeli që kryen funksionet e policisë kundrejt personelit që u përket posteve të tjera që bëjnë pjesë në Policinë e Shtetit.

Për personelin që u përket pozicioneve të Administratës së sigurisë publike, për sa nuk është parashikuar nga ky ligj, zbatohen, duke qenë në përputhje, normat që kanë të bëjnë me nëpunësit civilë të Shtetit.

5. Personeli që u përket pozicioneve të punëtorëve të përhershëm të shkollave të policisë dhe pozicionit të punëtorëve të magazinave të Trupës së rojeve të sigurisë publike, bën pjesë në pozicionet e Administratës civile të Punëve të Brendshme, sipas dispozitave të parashikuara nga neni 40.

Neni 24. Detyrat institucionale të Policisë së Shtetit

1. Policia e Shtetit i ushtron funksionet e veta në shërbim të institucioneve demokratike dhe të shtetasve, duke nxitur bashkëpunimin e tyre. Ajo mbron ushtrimin e lirive dhe të drejtave të shtetasve; mbikëqyr respektimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të masave të autoritetit publik; mbron rendin dhe sigurinë publike; merr masa për parandalimin dhe për shtypjen e veprave penale; jep ndihmë në rast fatkeqësish dhe aksidentesh.

Neni 25. Personeli i Policisë së Shtetit

1. Policia e Shtetit i kryen shërbimet institucionale me personel mashkullor dhe femëror, me barazi kompetencash, funksionesh, trajtimi ekonomik dhe përparimi në karrierë.
2. Kriteret psiko-fizike dhe aftësore që duhet të zotërojnë personat që u përkasin pozicioneve të Policisë së Shtetit, që kryejnë funksione policie. janë përcaktuar me vendim të Presidentit të Republikës, mbas vendimit të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 26. Transferimi i detyrave dhe i kompetencave

1. Detyrat dhe kompetencat që kryhen nga drejtoria e përgjithshme e sigurisë publike të Ministrisë së Brendshme, nga zyrat që janë në vartësinë e saj dhe nga trupat e shkrira, të cilët parashikohen nga neni 23, ushtrohen nga ana e Administratës së sigurisë publike dhe nga zyrat që janë në vartësinë e saj, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 27. Flamujt dhe dekorimet

1. Flamujt që u përkasin dhe dekorimet që u lejohen Trupës së rojeve të sigurisë publike dhe Trupës së policisë femërore, u janë caktuar Policisë së Shtetit.

Neni 28. Pajimet

1. Pajisjet, mjetet, intrumentet, pajimet, pasuritë e patundshme dhe çdo pajim tjetër që u përket trupave të përmendura në nenin 23, u janë caktuar Administratës së sigurisë publike .

Neni 29. Marrëveshjet dhe konventat me forcat e armatosura

1. Marrëveshjet për përdorimin e pajisjeve ushtarake, angazhimet e ndihmës dhe marrëveshjet me entet dhe me forcat e armatosura, të cilat janë në fuqi për personelin civil të sigurisë publike dhe për Trupën e rojeve të sigurisë publike, zbatohen për Administratën e sigurisë publike, me përjashtim të rastit kur vendoset ndryshe nga ana e Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin kompetent.

Neni 30. Armatimi dhe uniformat

1. Kriteret për përcaktimin e armatimit me të cilin pajiset Administrata e sigurisë publike dhe të personelit me pozicione në Administratën e sipërpërmendur që kryen funksione të policisë, përcaktohen, edhe në ndryshim me normat në fuqi në fushën e armëve, me vendim të Presidentit të Republikës, mbas vendimit të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm, në marrëveshje me Ministrin e Mbrojtjes dhe Ministrin e Financave, mbasi është dëgjuar mendimi i Komitetit kombëtar të rendit dhe të sigurisë publike .
2. Ministri i Brendshëm, me anën e një vendimi të vetin, përcakton karakteristikat e uniformave të efektivëve të Policisë së Shtetit, si edhe kriteret e përgjithshme që kanë të bëjnë me detyrimin dhe me mënyrat e përdorimit.

Neni 31. Rregullorja e Administratës së sigurisë publike

1. Administrata e sigurisë publike është e ndarë në:
 - 1) organet qendrore, sikurse parashikohen në nenet 4 dhe 5;
 - 2) kuesturat, zyrat provinciale të ndara me organizimin dhe me pajimet e personelit dhe të mjeteve që përcaktohen me vendim të Ministrit të Brendshëm;
 - 3) inspektoriatet dhe zyrat e posaçme të sigurisë publike, pa kompetenca territoriale, të cilat kanë detyra të posaçme për mbrojtjen dhe mbikëqyrjen, të krijuara atëherë kur e kërkojnë nevojat efektive, me organizimin, pajimet e personelit dhe të mjeteve që përcaktohen me vendim të Ministrit të Brendshëm;
 - 4) komisariate, të krijuara, të krijuara atëherë kur e kërkojnë nevojat efektive, me organizimin, pajimet e personelit dhe të mjeteve që përcaktohen me vendim të Ministrit të Brendshëm, mbasi është dëgjuar mendimi i autoriteteve provinciale të sigurisë publike;
 - 5) postet e policisë të shkëputura, të krijuara në vartësi të kuesturave, për nevoja të veçanta ose me karakter të përkohshëm, me organizimin, pajimet e personelit dhe të mjeteve që përcaktohen me vendim të shefit të policisë-drejtorit të përgjithshëm të sigurisë publike, mbasi është dëgjuar mendimi i autoriteteve provinciale të sigurisë publike;
 - 6) zyrat periferike në vartësinë e departamentit të sigurisë publike, për nevojat e policisë rrugore, hekurudhore, postare ose kufitare, me organizimin, pajimet e personelit dhe të mjeteve

që përcaktohen me vendim të Ministrit të Brendshëm, mbasi është dëgjuar mendimi i autoriteteve provinciale kompetente të sigurisë publike;

7) repartet e lëvizshme, të krijuara në vartësinë e departamentit të sigurisë publike, me organizimin, pajimet e personelit dhe të mjeteve që përcaktohen me vendim të Ministrit të Brendshëm;

8) institutet e arsimit, pranë departamentit të sigurisë publike, për nevojat e arsimit, stërvitjes dhe të specializimit të personelit sipas rregullores së përcaktuar në kreun IV;

9) kabinetet e policisë shkencore, repartet e fluturimit, repartet, krijimi i së cilave e ka prejardhjen nga nevojat e inkuadrimit, operative dhe të menaxhimit dhe të asistencës edhe shëndetësore të personelit, qendrat e bashkërendimit operativ, qendrat e grumbullimit të materialeve dhe të mjeteve, si edhe qendrat e telekomunikacioneve, qendrat e motorizimit, qendrat elektronike dhe mekanografike në nivel kombëtar, ndërajonal, rajonal dhe provincial, në vartësi të departamentit të sigurisë publike edhe për nevoja të përgjithshme mbështetjeje të Ministrisë së Brendshme, me organizimin, pajimet e personelit dhe të mjeteve që përcaktohen me vendim të Ministrit të Brendshëm. Për veprimtaritë specifike të policisë hetimore, gjyqësore dhe të sigurisë publike, mund edhe të përcaktohen, me vendim të Ministrit të Brendshëm, forma të bashkërendimit rajonal dhe ndërajonal. Strikturat shëndetësore ekzistuese pranë Ministrisë së Brendshme ruajnë destinacionin aktual funksional.

2. Pajimet e personelit dhe të mjeteve përcaktohen duke mbajtur parasysh organikën që rezulton nga zbatimi i gjithë sa është vendosur nga pika X) e nenit 36.

Neni 32. Kuestura dhe zyrat në vartësi.

1. Kuestura është zyra provinciale, e cila kryen detyrat e drejtimit dhe të organizimit të shërbimeve operative, si edhe funksionet që i janë caktuar nga ligji dhe nga rregulloret në fuqi.

2. Komisariatet dhe postet e policisë krijohen në lidhje me disa tregues të posaçëm që përcaktohen nga zyra që përmendet në nenin 5, shkronja a), duke mbajtur parasysh faktorët që ndikojnë mbi rendin dhe mbi sigurinë publike dhe duhet të jenë të destinuar për të realizuar një decentralizim të gjerë të funksioneve dhe të punësimit të personelit në komuna dhe në lagje, në mënyrë të veçantë për qëllimet e parandalimit.

3. Departamenti i sigurisë publike mund të autorizojë kuestorët që të delegojnë funksione të policisë administrative, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me masat e parandalimit, drejtuesve të komisariateve.

Neni 33. Repartet e lëvizshme

1. Repartet e lëvizshme janë krijuar për mbrojtjen e rendit publik dhe për nevojat e ndohmës publike.

2. Repartet e sipërpërmendura ose njësitë organike të vetë këtyre, mund të thirren për të bashkëpunuar në operacione të tjera të sigurisë publike dhe në shërbimet institucionale të kryera nga organet territoriale të policisë, mbasi të jetë dhënë autorizimi nga ana e shefit të policisë-drejtorit të përgjithshëm të sigurisë publike.

3. Reparteve të lëvizshme në shërbim të rendit publik u është caktuar, si rregull, personel mashkullor.

4. Detyrimi i qëndrimit në kazermë përcaktohet me norma të posaçme që i përmban rregullorja e shërbimit, sikurse parashikohet në nenin 111.

5. Repartet e lëvizshme duhet të kenë në dispozicion pajisje të përshtatshme për të dhënë ndihmë në raste fatkeqësish; personeli që kryen shërbimin në to duhet të jetë i përgatitur për detyrën e posaçme.

Neni 34. Zyrat e policisë rrugore, hekurudhore, postare dhe kufitare

1. Zyrat e policisë rrugore, hekurudhore, postare dhe kufitare marrin masa, në nivelet e kompetencës së tyre territoriale, për drejtimin dhe bashkërendimin operativ të zyrave përkatëse në të cilat ato ndahen.

2. Personat që u përkasin zyrave të sipërpërmendura bashkëpunojnë në operacionet e policisë që zhvillohen nga organet territoriale dhe nga repartet e lëvizshme, sipas normave të përcaktuara me rregulloren e shërbimit, sikurse parashikohet në nenin 111, paragrafi i parë.

3. Për qëllimet e zbatimit të bashkërendimit, sikurse parashikohet në kreun e parë, drejtuesit e zyrave të sipërpërmendura duhet t'i raportojnë kuestorit në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me rendin dhe me sigurinë publike .

Neni 35. Shpërndarja e Zyrës kundër drogës

1. Duke mbetur të pandryshuara detyrat e Ministrit të Brendshëm në fushën e bashkërendimit dhe të planifikimit të forcave të policisë, sikurse parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, është shfuqizuar neni 7 i Ligjit të datës 22 Dhjetor 1975, nr. 685.

2. Detyrat dhe kompetencat që i janë caktuar që më përpara zyrës për të cilën bëhet fjalë në nenin 7 të ligjit të cituar në paragrafin e mëparshëm, i caktohen departamentit të sigurisë publike, pranë të cilit është krijuar një shërbim i posaçëm i Drejtorisë qendrore të policisë kriminale, në të cilën përmbledhen personeli, strukturat dhe pajimet e vetë kësaj zyre.

KREU III - Rregullorja e personelit

Neni 36. Rregullorja e personelit

1. Qeveria e Republikës autorizohet që të shpallë brenda dymbëdhjetë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, një apo më shumë vendime që kanë vlerën e ligjit të zakonshëm për të marrë masa për përcaktimin e rregullores së personelit të Administratës së sigurisë publike, që duhet të harmonizohen me përshtatjet e duhura, me parashikimet e paraqitura në nenet 2, 3 dhe 4 të ligjit të datës 11 korrik 1980, nr. 312, duke respektuar parimet dhe kriteret drejtuese si më poshtë vijnë:

I) krijimi i pozicioneve për personelin që kryen funksione të policisë, të pozicioneve për personelin që zhvillon veprimtari tekniko-shkencore ose teknike edhe me karakter ekzekutiv, që ka të bëjë me shërbimet e policisë, si edhe të pozicioneve për personelin që kryen detyra me karakter profesional që kanë të bëjnë me shërbimet e policisë, për ushtrimin e të cilave nevojitet regjistrimi në urdhrat profesionale. per il cui esercizio occorre la iscrizione in albi professionali. Përmbushja e funksioneve me karakter institucional kryhet nga personeli që i përket pozicioneve të Administratës së sigurisë publike.

Përmbushja e funksioneve me karakter administrativ, kontabilizues dhe pasuror, si edhe e detyrave ekzekutive jo me karakter teknik dhe operativ, kryhet nga personeli që i përket pozicioneve të Administratës civile të Punëve të Brendshme;

II) nëndarja e personelit, që kryen funksione të policisë, në pozicionin e agjentëve, në pozicionin e asistentëve, në pozicionin e mbikëqyrësit, në pozicionin e inspektorëve, në pozicionin e komisarëve dhe në pozicionin e drejtuesve, duke respektuar dispozitat si më poshtë vijnë:

1) personelit që i përket pozicionit të agjentëve i janë caktuar detyra ekzekutive me mundësi nisme dhe pushteti vetëgjykimor që ka të bëjë me kualifikimin e agjentit të sigurisë publike dhe të policisë gjyqësore; në lidhje me vjetërsinë dhe me meritat e shërbimit duhet të parashikohen të paktën dy kualifikime, duke mbetur të pandryshuara detyrat e sipërpërmendura;

2) personelit që i përket pozicionit të asistentëve i janë caktuar detyra ekzekutive me mundësi nisme dhe pushteti vetëgjykimor që ka të bëjë me kualifikimin e agjentit të sigurisë publike dhe të policisë gjyqësore, si edhe detyra të specializuara të mundshme, të bashkërendimit dhe të komandës në një apo më shumë agjentëve në shërbim operativ; janë parashikuar të paktën tri kualifikime dhe atij të nivelit më të lartë i caktohet kualifikimi i oficerit të policisë gjyqësore;

3) personelit që i përket pozicionit të mbikëqyrësve i janë caktuar funksione në të njëjtën fushë, por të një niveli më të lartë në krahasim me ato që janë parashikuar në numrin e mëparshëm, me mundësi nisme dhe pushteti vetëgjykimor që ka të bëjë me kualifikimin e oficerit të policisë gjyqësore, si edhe funksione të komandës së posteve të policisë ose të njërive të vogla operative

së cilave u jep urdhra që u kontrollon zbatimin dhe për të cilat përgjigjet; duhet të parashikohen të paktën katër kualifikime dhe të përcaktohen funksionet përkatëse;

4) personelit që i përket pozicionit të inspektorëve i janë caktuar funksione specifike të sigurisë publike dhe të policisë gjyqësore, me vëmendje të veçantë ndaj veprimtarisë hetimore; janë caktuar, gjithashtu, edhe funksione të drejtimit, të përcaktimit dhe të bashkërendimit të njërive operative dhe përgjegjësia për direktivat ose për udhëzimet e dhëna në veprimtaritë e mëparshme dhe për rezultatet e arritura. Në rast mungese të përkohshme ose pengese, mund të zëvendësojnë përgjegjësia në drejtimin e zyrave ose të reparteve. Duhet të parashikohen katër kualifikime dhe të përcaktohen funksionet përkatëse;

5) personelit që i përket pozicionit të komisarëve i janë atribuuar funksione të sigurisë publike dhe të policisë gjyqësore, të drejtimit të zyrave, të komandës së reparteve, që sjellin për pasojë një kontribut të përgjegjshëm profesional dhe vlerësimin e mundësive në kuadrin e direktivave të marra; duhet të parashikohen të paktën katër kualifikime dhe të përcaktohen funksionet përkatëse;

6) personelit që i përket pozicionit të drejtuesve i janë caktuar, atëherë kur është e nevojshme, përveç funksioneve të parashikuara që më përpara nga vendimi i Presidentit të Republikës së datës 30 qershor 1972, nr. 748,

funksionet që mund të bëhet e nevojshme të parashikohen në kontekstin e rregullores të ri të Administratës së sigurisë publike ;

III) nëndarje e personelit që zhvillon veprimtari tekniko-shkencore ose edhe teknike me karakter ekzekutiv, që ka të bëjë me shërbimet e policisë, në pozicione që duhet të përcaktohen në lidhje me funksionet e caktuara dhe me përmbajtjet e kërkuara të profesionalizmit; përcaktimi i kualifikimeve dhe i funksioneve përkatëse;

IV) nëndarje e personelit që kryen detyra me karakter profesional, për ushtrimin e së cilave kërkohet regjistrimi në urdhrat e posaçme, në pozicione që duhet të përcaktohen në lidhje me funksionet e caktuara dhe me përmbajtjet e kërkuara të profesionalizmit; përcaktimi i kualifikimeve dhe i funksioneve përkatëse;

V) parashikim që, derisa nevojat e shërbimit nuk do të përmbushen nga personel që kryen detyra administrative, kontabilizuese dhe pasurore dhe nga personeli që i përket pozicioneve që duhet të krijohen sipas gjithë sa është parashikuar nga pikat e mëparshme III) dhe IV), personeli civil i sigurisë publike, i Trupës së policisë femërore dhe i Trupës së rojeve të sigurisë publike që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, zhvillon veprimtaritë e sipërpërmendura, do të vazhdojë, me përjashtim të nevojave të shërbimit dhe duke mbetur i pandryshuar inkuadrimi për të cilin do të ketë të drejtë, të zhvillojë veprimtaritë në të cilat është caktuar; e njëjta disiplinë i është rezervuar edhe personelit të caktuar për të zhvilluar veprimtari asistence apo që janë të lidhura me to;

VI) parashikim që personeli që përmendet në pikën e mëparshme V) të ketë akses në kërkesë dhe mbas një prove praktike në kualifikimet e ndryshme funksionale të vetë pozicioneve - deri tek ajo që përkon me kualifikimin kulmor të pozicionit drejtues - nëlidhje me detyrat e kryera gjatë kalimit në këto pozicione, deri në mbulimin e jo më shumë se pesëdhjetë përqind përkatësisht e pozicioneve të parashikuara për ushtrimin e detyrave të sipërpërmendura administrative, kontabilizuese dhe pasurore dhe të pajimeve organike të pozicioneve të parashikuara në pikat e mëparshme III) dhe IV);

VII) parashikim që mbas zbatimit të pikës së mëparshme VI) të mund të ketë akses, në kërkesë dhe mbas një prove praktike, në kufijtë e masës 50 përqind të pozicioneve të disponueshme për çdo kualifikim, në kualifikimet e ndryshme të pozicioneve, sikurse parashikohet në pikat e mëparshme III) dhe IV) edhe personel me prejardhje nga administrata të tjera të Shtetit, që zhvillon veprimtari teknike të njëjta me ato të vetë kualifikimeve; parashikim që personelit të sipërpërmendur t'i caktohet trajtimi ekonomik më i favorshëm, duke e konvertuar në pjesë

vjetërsie pjesën e trajtimit të mëparshëm që mund ta kapërcejë atë që parashikohet në pozicionet e reja;

VIII) parashikim, në përcaktimin e funksioneve për personelin për të cilin bëhet fjalë në pikat II), III) dhe IV) i detyrave të formimit dhe të arsimit;

IX) parashikim që përpara se të procedohet me inkuadrimin për të cilin bëhet fjalë në pikën X):

1) të njihet, për çdo efekt juridik dhe administrativ, shërbimi i kryer në pozicionin e ndihmësit nga funksionarët me këtë kualifikim, të emëruar mbas datës 25 prill 1945 dhe që kanë kaluar më pas në pozicion;

2) oficerëve të Trupës së rojeve të sigurisë publike t'u aplikohen, duke filluar nga e njëjta datë, përfitimet e përparimit në karrierë, që u lindin funksionarëve të sigurisë publike nga ligji i datës 11 korrik 1980, nr. 312;

3) oficerëve deri në gradën e tenentit kolonel, përpara se të procedojnë me operacionet për të cilat bëhet fjalë në pikën X), numër 19), u aplikohen, për qëllime ekskluzivisht juridike, kriteret e përparimit në karrierë, deri në kualifikimin e zëvendëkuestorit, të cilat parashikohen për funksionarët e sigurisë publike edhe përpara hyrjes në fuqi të ligjit të datës 11 korrik 1980, nr. 312.

Mbeten të pandryshuara kriteret për vlerësimin e vjetërsisë, të cilat janë përcaktuar në pikën X), numër 19), si edhe ato për kalimin në pozicione drejtuese, sikurse parashikohet në pikën XIII);

4) pajimi organik i drejtuesve të parë të policisë femërore të rritet nga katër në njëzet njësi dhe për caktimin e pozicioneve që kanë ardhur duke u shtuar të veprohet sipas kriterëve dhe mënyrave të parashikuara nga ligji i datës 30 shtator 1978, nr. 583;

X) përcaktimi, për secilën prej pozicioneve të krijuara dhe, atëherë kur është e nevojshme, për kualifikime të veçanta, të pajimet organike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i rregullores dhe efikasiteti i strukturave të administratës dhe për të shmangur që personeli që shkëputet nga detyrat që janë parashikuar në mënyrë specifike për çdo pozicion. Në mënyrë të veçantë:

1) parashikimi që personeli i cili ka aktualisht gradën e rojes së zgjedhur të inkuadrohet në kualifikimet e pozicionit të agjentëve, sipas vjetërsisë në shërbim;

2) parashikimi që personeli i cili ka aktualisht kualifikimin e tetarit, të inkuadrohet në pozicionin e asistentëve, sipas kriterëve si më poshtë vijojnë:

2a) inkuadrimi në kualifikimin e parë i tetarëve që kanë deri në pesëmbëdhjetë vite vjetërsie në shërbim, duke respektuar rendin e pozicionit;

2b) inkuadrimi në kualifikimin e ndërmjetëm i tetarëve që kanë deri në njëzet e katër vite vjetërsie në shërbim, duke respektuar rendin e pozicionit;

2c) inkuadrimi në kualifikimin përfundimtar i tetarëve që i kanë kapërcyer njëzet e katër vjet vjetërsie shërbimi ose dhjetë vjet vjetërsie grade, duke respektuar rendin e pozicionit;

3) parashikim që personeli që ka, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gradën e tetarit, dhe që ka rezultuar i aftë në konkurset për dhënien e gradës së zëvendësbrigadierit të sigurisë publike, të inkuadrohet në kualifikimi e dytë të pozicionit të mbikëqyrësve, në mbinumër të thithshëm me pushimin e shërbimit të personelit të caktuar në këtë pozicion, duke respektuar rendin kronologjik të konkurseve të veçanta dhe në kuadrin e secilit prej konkurseve klasifikimi sipas meritave për tetarët;

4) parashikim që personeli që ka, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gradën e zëvendësbrigadierit, të inkuadrohet, edhe në mbinumër, në kualifikimin e dytë të pozicionit të mbikëqyrësve dhe ai që i përket pozicionit të brigadierëve në kualifikimin e tretë të pozicionit të mbikëqyrësve;

5) parashikimi që marshallët të inkuadrohen në katër kualifikimet e pozicionit të inspektorëve, sipas kuotave të renditura si më poshtë vijojnë:

5a) gjysma e pozicioneve të disponueshme në kualifikimin përfundimtar;

5b) tri të pestat e pozicioneve të disponueshme në kualifikimet e ndërmjetme;

5c) dy të pestat e pozicioneve të disponueshme në kualifikimin fillestar;

6) parashikim që inkuadrimi për të cilin bëhet fjalë në numrin e mëparshëm të kryhet në mënyrën e mëposhtme:

6a) në kualifikimin përfundimtar, sipas rendit të klasifikimit, marshallët me detyrë të posaçme, të cilët e kanë kaluar një konkurs për tituj shërbimi, marshallët e klasës së I-rë të zgjedhur dhe të klasës së I-rë, të cilët e kanë kaluar një konkurs të brendshëm për për tituj shërbimi dhe intervistë, deri në mbulimin e kuotës që është parashikuar në numrin 5a);

6b) në kualifikimin e tretë, nella terza qualifica, marshallët me detyrë të posaçme, të cilët nuk e kanë kaluar konkursin ose nuk kanë marrë pjesë në të, si edhe, deri në mbulimin e kuotës që është parashikuar në numrin 5b), marshallët e klasës së I-rë të zgjedhur dhe të klasës së I-rë, të cilët janë kualifikuar si të aftë në konkursin e brendshëm të sipërpërmendur për titujt dhe në intervistë, që nuk kanë gjetur një vend në kualifikimin përfundimtar për mungesë të vendeve të disponueshme;

6c) në kualifikimin e dytë ose të parë, deri në mbulimin e kuotave që janë parashikuar në numrat 5b) dhe 5c), marshallët e klasës së I-rë të zgjedhur dhe të klasës së I-rë, të cilët janë kualifikuar si të aftë në konkursin e brendshëm të sipërpërmendur për titujt dhe në intervistë, që nuk kanë gjetur një vend në kualifikimin e tretë ose të dytë për mungesë të vendeve të disponueshme;

6d) parashikim që personeli për të cilin bëhet fjalë në numrat 6b) dhe 6c) të inkuadrohet në kualifikimin e dytë dhe pastaj në atë të tretë e të katërt të pozicionit të inspektorëve, sipas renditjes në klasifikim, dhe atëherë kur nuk ka më pas meritë për shkak të pozicioneve që bëhen të disponueshme me kalimin e kohës në ato kualifikime dhe në kufijtë e kuotave që janë parashikuar në numrin 5);

7) parashikim që, mbasi të ketë përfunduar inkuadrimi për të cilin bëhet fjalë në pikat e mëparshme dhe mbasi të jetë verifikuar disponueshmëria e pozicioneve në kualifikimin e tretë, të dytë dhe të parë të pozicionit të inspektorëve, të shpallet një konkurs i brendshëm për titujt e shërbimit dhe intervista, që u rezervohet marshallëve të klasës së II-të dhe të III-të;

7a) parashikim që personeli, i cili e ka kaluar konkursin për të cilin bëhet fjalë në numrin e mëparshëm 7), të inkuadrohet në kualifikimin e tretë, të dytë ose të parë të pozicionit të inspektorëve, deri në mbulimin e kuotave të parashikuara nga numrat 5b) dhe 5c);

7b) parashikim që personeli që është kualifikuar i aftë në konkursin për të cilin bëhet fjalë në numrin e mëparshëm 7), që nuk ka gjetur vend në kualifikimin e parë për mungesë vendesh të disponueshme, të inkuadrohet, sipas renditjes me meritë, në kualifikimin përfundimtar të pozicionit të mbikëqyrësve;

7c) parashikim që personeli, për të cilin bëhet fjalë në numrat e mëparshëm 7a) dhe 7b), të inkuadrohet, sipas rendit të klasifikimit dhe atëherë ku të mos ketë më tej meritë, në kualifikimin e parë e pastaj në të dytin, në të tretin dhe në të katërtin të pozicionit të inspektorëve sipas pozicioneve që do të bëhen të disponueshme me kalimin e kohës në ato kualifikime dhe në kufijtë e kuotave të parashikuara në numrin 5);

8) parashikim që marshallët e inkuadruar në pozicionin e inspektorëve të ndjekin pranë një shkolle policie një kurs përditësimi me kohëzgjatje të paktën prej dy muajsh;

9) parashikim që asistentët e policisë, të cilët të kenë mbushur vitin e 13-të të shërbimit të inkuadruhen në kualifikimin e katërt të pozicionit të inspektorëve; parashikim që asistentët e policisë që kanë mbushur deri 13 vjet shërbimi të inkuadruhen në kualifikimin e tretë të pozicionit të inspektorëve, duke u dhënë përparësi në pozicion atyre që hyjnë më pas me konkurs;

10) parashikim që marshallët e klasës së I-rë të zgjedhur dhe të klasës së I-rë, të cilët nuk e kanë kaluar konkursin për të pasur akses në pozicionin e inspektorëve ose që nuk kanë marrë pjesë në të, të inkuadruhen në kualifikimin përfundimtar të pozicionit të mbikëqyrësve ose më saktë, me kërkesë, në pozicionin e posaçëm deri në mbarimin e tij, sikurse parashikohet në numrin 14);

- 11) parashikim që marshallët e klasës së II-të dhe të klasës së III-të, të cilët nuk e kanë kaluar konkursin për të pasur akses në pozicionin e inspektorëve ose që nuk kanë marrë pjesë në të, të inkuadrohen në kualifikimin e III-të, për pozicionin e mbikëqyrësve ose më saktë, me kërkesë, në pozicionin e posaçëm deri në mbarimin e tij, sikurse parashikohet në numrin 14);
- 12) parashikim që marshallët e klasës së parë të zgjedhur dhe ata të klasës së parë, të cilët nuk kanë marrë pjesë në konkurs ose që nuk e kanë kaluar konkursin për të cilin bëhet fjalë në pikën 6a), të quhen kalues në kualifikimin e dytë për pozicionin e inspektorëve që nga dita përpara asaj të pushimit të shërbimit për kufij moshe, sëmundjeje ose vdekjeje, me trajtimin ekonomik më të favorshëm;
- 13) parashikim që marshallët e klasës së dytë dhe të tretë, të cilët nuk kanë marrë pjesë në konkurs ose që nuk e kanë kaluar konkursin për të cilin bëhet fjalë në pikën 7), të quhen kalues në kualifikimin fillestar për pozicionin e inspektorëve që nga dita përpara asaj të pushimit të shërbimit për kufij moshe, sëmundjeje ose vdekjeje, me trajtimin ekonomik më të favorshëm;
- 14) parashikim që nënoficerët, të cilët bëjnë kërkesë, edhe mbas dhënies së provimeve për të pasur akses në kualifikimet si inspektorë, të inkuadrohen në pozicionet e posaçme deri në mbarimin e tyre;
- 15) parashikim që nënoficerët dhe tetarët me pozicion të ndarë dhe të kufizuar, sikurse parashikohet nga nenet e datës 11 korrik 1956, nr. 699, 22 dhjetor 1960, nr. 1600, 14 shkurt 1970, nr. 57, 10 tetor 1974, nr. 964, si edhe ata në mbinumër, sikurse parashikohet në ligjin e datës 27 shkurt 1963, nr. 225, ose që sidoqoftë janë thirrur në shërbim, të futen në një pozicion deri në mbarim; parashikim që personeli i sipërpërmendur të mund të përparojë në karrierë sipas mënyrave të rritjes në karrierë që janë parashikuar për ata me të njëjtën gradë për pozicionin e zakonshëm dhe në kufijtë e përqindjeve që janë përcaktuar në numrin 32);
- 16) parashikim që për personelin për të cilin bëhet fjalë në numrin 15), në kohën e pushimit të shërbimit për çfarëdolloj arsyeje, të merren masa, veçm për qëllimet e trajtimit të pensionit, për rindërtimin e karrierës që nga data e hyrjes në shërbim sipas normave në fuqi për personelin që u përket pozicioneve të zakonshme;
- 17) parashikim që nënoficerët dhe tetarët që kanë kryer shërbim në Trupën e rojeve të sigurisë publike në cilësinë e rojeve zëvendësuese dhe ndihmëse, në qoftë se në momentin e vënies në lirim për shkak të kufirit të moshës ose për shkak të sëmundjes, ose në çastin e vdekjes, nuk janë inkuadruar në pozicionin e inspektorit, t'u caktohen rritje periodike të barabarta me 2,50 përqind të rrogës për çdo trevjeçar ose fraksion kohor që sidoqoftë është më i lartë se gjashtë muaj shërbimi të kryer në cilësinë e zëvendësuesve ose të ndihmësve;
- 18) parashikim që funksionarët e sigurisë publike deri në kualifikimin e zëvendëskuestorit dhe oficerët e Trupës së të rojeve të sigurisë publike deri në gradën e tenentit kolonel të pozicionit të zakonshëm, të inkuadrohen, duke mbetur të pandryshuara pozicionet e zëna në postet përkatëse, në postin drejtues të Administratës së sigurisë publike ;
- 19) parashikim që inkuadrimi i personelit për të cilin bëhet fjalë në numrin e mëparshëm në kuadrin e secilit kualifikim, të kryhet duke pasur parasysh vjetërsinë e shërbimit dhe të gradës së kualifikimit, të ngritjes në gradë me zgjedhje ose për meritë të krahasueshme ose për merita të jashtëzakonshme, vlerësimet e arritura, kualifikimet vjetore të marra, titujt, detyrat e kryera. Vjetërsia në shërbim përcaktohet për funksionarët që nga data e fillimit të emërimit deri në kualifikimin fillestar dhe për oficerët që nga data e emërimit deri në gradën e tenentit ose që nga data e emërimit në gradën e nëntenentit për oficerët që janë pranuar në Trupë mbasi kanë marrë pjesë në konkurse për rekrutim që u rezervohen atyre me diplomë universitare;
- 20) parashikim që për inspektorët, për inspektorët e larta dhe për zëvendësinsektorët e policisë femërore, të aplikohet, në lidhje me inkuadrimin, gjithë sa është parashikuar nga numrat 18) dhe 19);
- 21) parashikim që drejtuesit e lartë, drejtuesit e parë, duke përfshirë edhe ata të policisë femërore, gjeneralët madhorë dhe kolonelët, të inkuadrohen në pozicionin e drejtuesve të

Administratës së sigurisë publike, duke mbetur të pandryshuara pozicionet e zëna në postet përkatëse;

22) parashikim që inkuadrimi në kualifikimet e ndryshme, të personelit për të cilin bëhet fjalë në numrin e mëparshëm, të kryhet duke pasur parasysh vjetërsinë e shërbimit dhe të gradës ose të kualifikimit, të ngritjes në gradë me zgjedhje ose për meritë të krahasueshme ose për merita të jashtëzakonshme, vlerësimet e arritura, kualifikimet vjetore të marra, titujt, detyrat e kryera. Për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme, merr masa organi kolegjial kompetent, sikurse parashikohet nga neni 38. Për drejtuesit e përgjithshëm të sigurisë publike dhe për tenentët gjeneralë aplikohen dispozitat e parashikuara nga neni 42;

23) parashikim që zëvendëskuestorët, të vendosur në pozicion deri në mbarim të vendeve, brenda datës 01 korrik 1980, të inkuadrohen në pozicionin e drejtuesve, në kualifikimin e drejtuesit të parë në mbinumër që duhet të thithet gjatë rishikimit të pajimeve organike të parashikuara nga pika e mëparshme X);

24) parashikim që tenentët kolonelë të inkuadrohen, atëherë kur bëjnë kërkesë, në një pozicion derisa mbarohen vendet;

25) parashikim që tenentët kolonelë, të cilët i përkasin pozicionit unik të ndarë dhe të kufizuar ose që sidoqoftë thirren në shërbim, të futen në një pozicion deri në mbarim të vendeve; parashikim që personeli i sipërpërmendur të ketë mundësi që të përparojë në karrierë deri në gradën e majorit gjeneral sipas mënyrave të rritjes në detyrë që janë percaktuar për gradë të barabarta në pozicionin e zakonshëm dhe në kufirin e përqindjeve të percaktuara në numrin 32);

26) parashikim që për për personelin për të cilin bëhet fjalë në numrin 25), në çastin e pushimit të shërbimit për çfarëdolloj shkak, të merren masa, vetëm për qëllimet e trajtimit të quiescenzës, për rindërtimin e karrierës që nga data e hyrjes në shërbim sipas normave në fuqi për personelin që u përket pozicioneve të zakonshme;

27) parashikim që tenentët gjeneralë, majorët gjeneralë dhe kolonelët të inkuadrohen, sipas kërkesës, në një pozicion derisa të mbarohen vendet; parashikim që oficerët e sipërpërmendur, në qoftë se thirren ose janë në pozicionin e gjendjes «në dispozicion» ose «në pritje të reduktimit të kuadrove», të inkuadrohen drejtpërdrejt në pozicionin e sipërpërmendur deri në mbarimin e vendeve; parashikim që oficerët e pozicionit të mjekëve të inkuadrohen në një pozicion deri në mbarimin e vendeve, me përjashtim të rastit kur në kohën e krijimit të pozicioneve profesionale, sikurse parashikohet në pikën IV), ata të zgjedhin kalimin në pozicionet e reja;

28) parashikim që asistentet e policisë femërore me tre gjithsej tre vjet shërbimi, që zotërojnë një nga diplomat universitare që parashikohen nga ligji i datës 01 dhjetor 1966, nr. 1082, paraqesin kërkesë për kualifikim fillestar për pozicionin e komisarëve, në kufirin e një të gjashtës së vendeve të disponueshme, nëpërmjet konkursit të brendshëm për titujt e shërbimit dhe intervistën që duhet të kryhet brenda dymbëdhjetë muajsh që nga miratimi i masës së deleguar që parashikohet nga ky nen; fitueset e konkursit të sipërpërmendur do të duhet të ndjekin një kurs të posaçëm përditësimi profesional;

29) parashikim që personat që i takojnë pozicionit të policisë femërore, të cilat paraqesin kërkesë, të inkuadrohen në një pozicion deri në mbarimin e vendeve, duke e ruajtur gjendjen juridike aktuale dhe përparimin aktual në karrierë, si edhe përfitimet që lindin nga normat në fuqi që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

30) parashikim që asistenteve të policisë femërore, të cilat janë në shërbim në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të vazhdojnë t'u aplikohen, për një periudhë prej dhjetë vjetësh, për un periodo di dieci anni, normat në fuqi për aksesin në karrierën drejtuese sikurse parashikohet nga direktiva për nëpunësit civilë të Shtetit

31) parashikim që i nënoficerët dhe rojet e Trupës së rojeve të sigurisë publike, atëherë kur zotërojnë një diplomë universitare që kërkohet për aksesin në pozicionin e komisarëve, dhe që të kenë të paktën gjithsej pesë vjet shërbimi, të paraqesin kërkesë, për kualifikim fillestar për

karrierën e komisarit, në kufijtë e një të katërtës së vendeve të disponueshme, nëpërmjet konkursit të brendshëm për titujt e shërbimit dhe intervistën që duhet të kryhet brenda dymbëdhjetë muajsh që nga miratimi i masës së deleguar që parashikohet nga ky nen. Fituesit e konkursit të sipërpërmendur do të duhet të ndjekin një kurs përditësimi profesional.

32) parashikim që personeli i inkuadruar në pozicione deri në mbarimin e vendeve, që i përket Trupës së shkrirë të rojeve të sigurisë publike, të vazhdojnë t'i aplikohen përsa i përket përparimit në karrierë, normat në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për personelin e sipërpërmendur parashikohen edhe përfitimet që do t'u jepen edhe gradëve përkatëse të forcave të tjera të policisë.

Përparimi në karrierë vendoset nga Këshilli Administrativ sikurse parashikohet në Tekstin Unik të miratuar me vendim të Presidentit të Republikës, të datës 10 janar 1957, nr. 3, të ndryshuar nga neni 7 i ligjit të datës 28 tetor 1970, nr. 775.

Përparimi në karrierë i nënoficerëve do të duhet të kryhet në lidhje me pushimet e shërbimit që do të përcaktohen për secilin pozicion dhe në gradët e veçanta në datën 31 dhjetor të çdo viti.

Kuota e tenentëve kolonelë që do të pranohen për vlerësim do të përcaktohet në bazë të 1/6 në vit të tenentëve kolonelë që janë të regjistruar në pozicion dhe ngritjeve në detyrë që do të jepen në bazë të 10 përqind të oficerëve të vlerësuar.

Për ngritjen në gradën e majoit gjeneral do të veprohet duke pranuar në vlerësim 1/5 në vit të kolonelëve të regjistruar në pozicion dhe duke i dhënë ngritjen në detyrë njërit prej tyre në vit.

Majorët gjeneralë të regjistruar në pozicionin deri në mbarimin e vendeve, duke përfshirë edhe ata të pozicionit shëndetësor të oficerëve mjekë të policisë në përmbushjen e vitit të tretë të shërbimit në këtë gradë, vlerësohen dhe, në qoftë se deklarohen të aftë, ngrihen në gradën e tenentit gjeneral, duke filluar që nga dita përpara pushimit nga shërbimi për kufijtë e moshës ose për paaftësi fizike ose për shkak vdekjeje;

XI) Parashikimin që personeli në detyrë (*dmth personeli që është i pa liruuar, pasi ekziston instituti i gradës, pra ndodh që mund të jetë "LIRUAR", por akoma është në Polici, pra nuk paguhet por është pjesë e trupes*) kur mbaron merr funksione dhe detyrime që rrjedhin nga personeli i Policisë së Shtetit sipas këtij ligji, si dhe emërtesën që korrispondon sipas kualifikimeve të parashikuara në sistemin civil të personelit, përveçse kur ka mundësinë për të mbajtur, me kërkesë të tij, emërtesën e mëpërparme.

XII) Parashikimin që personeli civil për sigurinë publike me gradën zëvendës kuestor në detyrë, kur mbaron si dhe ai i kryeispektorit në detyrë kur mbaron sipas nenit 115, paragrafi i fundit, të ligjit 11.07.1980, n. 312, kryen funksionin sipas gradës më të lartë të komisarëve.

XIII) Parashikimin që qasja (hyrja) në nivelin e drejtorëve, në lidhje me personelin që kryer funksione policore, të bëhet nëpërmjet kalimit të një kursi formimi në të cilin duhet të pranohen, sipas një numri sa njëherë e gjysëm vendet (pozicionet) në dispozicion, për ata që kanë kaluar një konkurs të brendshëm të bazuar mbi titujt (diplomat dëshmitë në letra) dhe provimin. Në këtë konkurs kanë të drejtë të marrin pjesë:

ata që i përkasin gradës së fundit të rankut drejtues, ose ata që kanë të paktën nëntë vjet e gjashtë muaj në shërbim efektiv në detyrë dhe që plotësojnë kushtet e nevojshme për kryerjen e funksioneve drejtuese, përcaktimin e kritereve për pranimin në konkurs, duke mbajtur parasysh titujt e fituar dhe vjetërsisë në shërbim dhe të kualifikimeve, si edhe mënyrat e kursit të formimit drejtuesor.

Në zbatimin e parë të këtij ligji dhe deri pas 18 muajve nga nxerrja e aktit nënligjor të parashikuar nga ky nen, vende e grumbulluara deri në 31 dhjetor 1980 dhe ato që sidoqoftë bëhen të disponueshme në funksionet të drejtuesit të parë jepen nëpërmjet shqyrtimit të meritave krahasuese sipas kriterëve dhe mënyrave të parashikura në ligjin e datës 30.09.1978, nr. 583, neni 12//a, ata që janë pranuar duhet të frekuentojnë një kurs perditësimi profesional.

XIV) Parashikimin që personeli drejtues sipas pikave III dhe IV të mund të ketë akses (nranohet) në funksionet drejtuese, nëse parshikohet, sipas modaliteteve të parashikuara në pikat XIII

XV) Parashikimin që promovimi për gradën drejtues i lartë të jepet në bazë të vendeve në dispozicion deri më 31 dhjetor të cdo viti, drejtuesve të parë që kanë maturuar një vjetërsi të paktë prej 3 vjetësh në nivel, duke marrë parasysh edhe periudhën e kaluar në detyrë me mbarim, sipas kriterëve krahasuese meritash të cilat caktohen veçanërisht në lidhje me shërbimet e kryesra dhe cilësinë e përshkrimit të caktuar sipas kompetencave specifike apo profesionale apo si mbatje e përgjegjësisë të veçanta edhe në raport me vendin e kryerjes së shërbimit, parashikimin që pas një tre vjecari nga hyrja në fuqi e këtij ligji, drejtuesit e parë të vlerësuar e jo të promovuar në funksionin më të lartë që kanë mbushur 30 vjet shërbim efektiv, të cilët në funksion janë deklaruar në pushim (lirim, dmth jo largim) me gradën si drejtues i lartë.

XVI) Përcaktimin e kriterëve për promovimin për merita të jashtëzakonshme edhe mbi numërin e caktuar, nëse ka poste vankante të zakonshme për numrin e punonjësve që i përkasin policisë.

XVII) Parashikimin që qasja në detyrë e asistentit të bëhet për vjetërsi dhe që pranimi në nivelin e fundit të funksionit të bëhet pasi të jetë ndjekur kursi i përditësimit me sukses.

XVIII) Parashikimi që qasja (pranimi) në funksionin e eprorit të bëhet nëpërmjet konkursit të brendshëm, në bazë të një provimi teoriko-praktik, në të cilin mund të marrin pjesë ata që i përkasin funksionit të agjentit dhe asistentit dhe që kanë të paktën 4 vjet në shërbim kompleksiv dhe që kalojnë më pas një kurs formimi teknik-profesional. Për personelin në shërbim në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen, sa i takon vjetërsisë së shërbimit të duhur, për të marrë pjesë në konkurs për epror, legjislacioni i parashikuar për konkursin e zëvendësbrigadierit.

XIX) Parashikimi për procedurat e shpërndarjes nëpër zyra dhe detyra dhe kriteret e promovimit në detyra të ndryshme me qëllim që të favorizohen ata që kanë me shumë ekspertise në shërbim dhe elementet që kanë merita për aftësi profesionale, vendosjen e procedurave në lidhje me semundjet e vecanta ose shkallen e përshtatshmerisë në strukturat e policisë kalim të personelit për nevoja ose sipas kërkesave në detyra të tjera ose role të tjera në administratën e sigurisë publike ose në administratë tjetër shtetërore duke ruajtur të drejtat dhe pozicionin e personelit që i përket këtyre të fundit.

XXI) Rregullimin e gjendjes juridike të personelit dhe në vecanti të komandës pranë administratave të tjera, pritshmerite, kohën në dispozicion, lejet, paaftësi, raportet informative sipas kriterëve që mbahen parasysh për vecoritë dhe nevojat e shërbimit policor dhe disiplinës për të cilën nuk parashikohen trajtime më të ulta se sa ato të punonjësve civilë të Shtetit.

XXII) Atribuimin kur është e mundur e kufizimit të funksioneve të ushtruara nga agjentët dhe oficerët e policisë gjyqësore dhe të sigurisë publike të personelit që kryen aktivitetet teknik-shkencor dhe të karakterit profesional në lidhje me detyrën që i përket.

XXIII) Motivimin e levizjes së personelit duke përjashtuar në të njëjtën kohë cdo lloj levizje jashtë administratës me përjashtim të detyrave të komanduara ose punësimit të perkohshëm jashtë detyrës.

XXIV) Parashikim që duke pasur parasysh rasteve të përmendura në paragrafin XV), personeli me hyrjen në detyrë në fuqi të këtij ligji, si edhe në përputhje me rregulloret në fuqi lidhur me

pensionin për shkak të arritjes moshës, ndërprerja e marrëdhënies së punës përcaktohen në mënyrë të ndryshme për personat që mbajnë detyra të ndryshme dhe bëhet kur mbushin moshën 60 vjeç.

XXV) Parashikimin që për të mbuluar nevojat e organikes të jete e mundur thirrja në shërbim të agjenteve, asistentëve dhe mbikqyresve për një periudhë jo më shumë se 2 vjetë por që të mos jete në pension, pas moshës 58 vjeç.

XXVI) Parashikimin që për drejtimin e personelit të Policisë së Shtetit të krijohen një apo më shumë organe kolegjiale duke patur përfaqësimin e të njëjtit personel.

Perfitimet sipas nenit 7 të Ligjit të 10 Tetorit 1974, nr 496 shtrihen edhe ndaj oficerëve të detyrave të tilla si ish komandantë apo partizane në shërbim që prej 1 Janarit 1971.

Neni 37. Kualifikimet e rolit të inspektoreve dhe stafit perkates organik

1. Roli I inspektorit ndahet në kater kualifikime sipas emertimeve në: neninspektor, inspektor, inspektor ki pare dhe kryeinspektor

2. Personeli në detyrë I inspektoreve përbehet nga 7.000 njësi të shpërndara sipas cdo kualifikimi:

Nen inspektor	njësi 2.500
Inspektor	njësi 2.000
Inspektor i pare	njësi 1.500
Kryeinspektor	njësi 1.000

3. Qendrushmeria organike e personelit të agjenteve, të asistentëve dhe të mbikqyresve do të jete sipas personelit të trupës së oficerëve të sigurisë publike dhe policëve (femra) në mënyrë proporcionale e reduktuar në 7.000 njësi.

Neni 38. Pozicionimi i personelit

1. Staf i operativ i parashikuar nga neni 36 parashikohet me urdher të Ministrisë të Brendshme pas një konsultimi me një komision të kryesuar nga një nënsekretar shteti i deleguar nga Ministri i përbërë nga Drejtori policisë-Drejtori i Përgjithshëm i Sigurisë Publike ose i deleguar prej tij një Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, nga kater drejtues, përfaqësues të Administratës dhe kater përfaqësues të personelit të caktuar nga sindikatat e policisë si me të përfaqësuarit në plan kombëtar.

Neni 39. Atributet dhe kualifikimet

1. Detyrës së agjentit të Policisë së Shtetit i atribuohet kualifikimi i Agjentit të Sigurisë Publike dhe Agjentit të Policisë Gjyqësore.

2. Detyrës së mbikqyresve, inspektoreve dhe kualifikimit të asistentëve, i atribuohet detyra e Agjentit të Sigurisë Publike dhe Oficerit të Policisë Gjyqësore.

3. Detyrës së drejtuesve të personelit i atribuohet kualifikimi i Oficerit të Sigurisë Publike.

4. Drejtuesit e pare që kryejnë funksionet e nënkuestorit, apo ata që kryejnë role drejtuese të personelit dhe kryejnë edhe funksione të policisë i atribuohet çështja e

Oficierit te Polise Gjyqesore.

Neni 40. Roli i Administrates Civile te brendshme

1. Në lidhje me veçantinë e detyrave të përcaktuara me dispozitat e zbatueshme dhe nga ligji për Administratën Civile të Brendshme, edhe për veprimtarine mbështetëse të zyrave qendrore dhe lokale te Ministrise, te varuara nga autoritetet e sigurisë publike, Qeveria e Republikës ka fuqinë për të siguruar, brenda dymbëdhjetë muajve pas hyrjes te vete ligjit me një Dekret që ka forcën e ligjit të zakonshëm, përcaktimin e e stafit dhe organizimin e zyrave të Administratës Civile Brendshme, duke respektuar parimet dhe udhëzimet e mëposhtme.

2. Per sa i perket personelit zbatimi i parimeve të përgjithshme të standardeve publike shtetërore të punësimit duhet të përcaktohet brenda kufijve të kushteve të përmendura në paragrafin e mësipërm dhe pas dëgjimit të sindikatave më përfaqësuese në nivel kombëtar, për ristrukturimin dhe karrieren e stafit ndihmës dhe personelit ne sherbim, në përputhje me pozitat ligjore.

3. Ne perputhje me dipozitat e meparshme jane rregulluar edhe detyrat e personelit operativ duke perfshire edhe detyrat e stafit te perhershem te shkollave te policise dhe detyrat e magazinjereve ne strukturat e trupes se Sigurise Publike. Gjithashtu jane percakuar kualifikimet e zanateve, strukturave organike dhe normat e pozicionimit te personelit qe do te perdoret ne menyre te vazhdueshme ne komunitetin e Policise se Shtetit.dhe Forcave te Sigurise Publike

4. Jane percaktuar norma te veçanta qe perjashtojne çdo lloj levizshmerie te jashtme ne Administrate perveç atyre qe rezultojne nga komanda ose te lene jashte detyre.

5. Janë percaktuar, pasi jane degjuar sindikatat, rregullat, te cilat ne respekt te lirise e shoqërimit, lejojne te shmangen përçarje për vazhdimësinë e shërbimeve thelbësore për zbatimin e ligjit dhe Sigurinë Publike, per zyrtarët ose punonjësit të Administratës Civile te Brendshme.

6.Keto norma krijojne kuadrin e shërbimeve thelbesore, ndërprerja e të cilave ndikojnë në mbrojtjen dhe Sigurinë Publike.

Articolo 41. Perfaqesimi i personelit ne Keshillin e Administrimit.

Perfaqesuesit e personelit sipas shkronjes d) te pargarafit te pare te nenit 145 te tekstit te vetem te miratuar me Dekretin e 10 Janarit 1957, ndryshuar me nenin 7 te ligjit te vitit 1970 (nr. 775), zgjidhen drejtperdrejte nga personeli i Policise se Shtetit.

Neni 42. Emerimi i Drejtuesit te Sigurise Publike te nivelit B dhe emerimi dhe pozicionimi i Prefektit

1. Ne kuadrin e pozicionimit organik ndermjet te cilave edhe tabela B bashkengjitur, Dekretit Legjislativ i 19 Majit 2000 per maksimumin prej 17 vende prefektesh parashikon emerimin dhe pozicionimin e rezervuar per drejtuesit e Policise se Shtetit qe kryejne funksione policore.

2. Drejtoret e pergjithshem te Sigurise Publike te nivelit B emeriohen ndermjet rangut drejtueseve te pergjithshem.

3. Përveç siç parashihet në paragrafin 4, drejtoret e përgjithshëm te nivelit B te Sigurise Publike janë klasifikuar në titullin e prefektit në përputhje me paragrafin 1, brenda një

periudhe prej jo më pak se tre vjet pas marrjes së kualifikimit, duke ruajtur efektet e vjetërsisë edhe në kualifikimin e drejtuesit të përgjithshëm të Sigurisë Publike.

3-bis. Drejtoreve të përgjithshëm të nivelit B të cilët janë në pension për shkak të arritjes së moshës sipas parashikimeve të pikës 3, i korrespondojnë nëse është e favorshme trajtimi normal dhe i privilegjuar i përfitimeve sikundër i përket prefekteve me të njëjten eksperiencë dhe përfituesve të nivelit të Drejtorit të Përgjithshëm ose nivel të njëjte me të.

4. Prefektet sipas pikës 3, mund të emerohen edhe të shumtë në numër deri në 30 Qershor 2004. Nuk mund të emrohen në këto detyra drejtore të përgjithshme të Sigurisë Publike të nivelit B.

5. Për prefektet dhe drejtoret e sigurisë publike të nivelit B dhe drejtoret e përgjithshme, psh; të zyrave të departamenteve të sigurisë publike merren parasysh edhe kriteret profesionale edhe vjetëria në punë.

6. Në lidhje me sa është parashikuar në paragrafin 3 dhe në nenin 20 të Dekretit Legjislativ të 19 Majit 2000, nr 139, kualifikimi i Prefektit sipas nenit 2, paragrafi 1 i Dekretit n.139 të vitit 2000 duhet të kuptohet në rang jo më të ulët se sa niveli drejtues B

Neni 43. Trajtimi ekonomik

1. Trajtimi ekonomik I personelit të policisë së Shtetit duke përjashtuar drejtuesit rregullohet në bazë të marrëveshjeve të përmenduar në nenin 95 me Dekret të Presidentit të Republikës pas shqyrtimit nga Këshilli i Ministrave duke marrë parasysh nevojën e miratimit të ligjit lidhur me shpenzimet e buxhetit të shtetit.

2. Marrëveshjet janë për 3 vjet.

3. Trajtimi ekonomik I personelit që kryejnë funksionet policore përbëhet nga niveli i pagës së shpërblimit dhe një kompensim të daljes në pension, të përcaktuar sipas funksioneve dhe atributëve të profesionalizimit të kërkuara si edhe përgjegjësinë dhe rrezikun lidhur me shërbimin.

4. Në negociatat për përcaktimin e shpërblimit të referuar në paragrafin e mëparshëm sindikatat e policisë marrin pjesë në mënyrën dhe formën e parashikuar në nenin 95.

5. Parashikohen përveç asaj fillestare disa nivele pagash sipas progresionit në karrierë.

6. Përfitimi i referuar në paragrafin e tretë I referohet caktimit të funksionit parashikuar nga neni 143 i Ligjit të 11 Korrikut 1980, nr. 312.

7. Për qellime pozicionimi sipas nenit 36, kualifikimet e detyrave të personelit që

kryen funksione te policise jane shprehndare ne nivelet e shperblimeve sipas Ligjit te 11 Qershorit te vitit 1980 nr. 312 ose atyre korresponduese ne aktin e hyrjes ne fuqi te ligjit te tanishem si meposhte vijon:

a) Niveli IV: agjent, agjent i dyte, asistent i pare, asistent i dyte:

b) Niveli IV: asistent i trete, epror i pare, epror i dyte, epror i trete.

c) Nivel I VI: epror i katert, inspektor i pare, inspektor i dyte.

d) Niveli VI bis: inspektor i dyte, detyrat e inspektorit i atribuohen nivelit te pages sipas nivelit VI dhe rritje me 50 per qind te parashikuar nga niveli i VII.

f) Niveli I VIII: kualifikimi i trete ne detyre drejtuesw.

g) Niveli VIII bis: kualifikimi I detyres drejtues i atribuohet nivelit te pages te parashikuar nga paragrafi I dyte I nenit 137 te Ligjit te 11 Korrikut te vitit 1980 nr. 312.

8. Ne detyre drejtuese jane pozicionuar personat e kualifikimit te trete me 4 vjet vjetersi.

9. Marshalleve te larte me detyre te vecante ne Trupen e Karabinierëve dhe trupes se Guradia di Finanzia i atribuohet trajtimii ekonomik i parashikuar per personelin pra ne nivelin VI bis.

10. Personelit civil te Sigurise Publike qe per efekt promovimi ne kuptim te paragrafit te fundit te nenit 155 te Ligjit te 11 Korrikut nr. 312 i referohet kualifikimi i nenkuestorit ne detyre te cilit I atribuohet trajtimi ekonomik I parashikuar ne nenin 133, paragrafi I dyte ne ligjin e cituar nr. 312.

11) Ne zbatim te ketij ligji I akordohet personelit te Policise se Shtetit nje shume pensioni qe i njihet si pasoje e sherbimit ne karriere. Masa e kesaj shume duhet te vendoset ne lidhje me eksperiencen ne pune qe nga 1 Janari 1978.

12. Personelit te Policise se Shtetit te cilit per afekt te kalimit ne detyren prej nga vjen ne detyren sipas nenit 36 , I takon nje rroge me e ulet se sa ajo qe do ti paguhej ne detyren me nje kualifikim me te larte se anga ajo prej te cles vjen. I atribuohet edhe shperblimi ne nivel te njejte me ate te marr en nivelin e atyres se orgjines.

13. Per nevoja funksionale te sherbimit policor ne perputhje me gadishmerine efektive te organikes rregullohet me dekret te Ministrit te Brendshem ne bashkepunim me Ministrin e Thesarit numri i pergjithshem i orareve shtese te punes per tu kryer si pune e jashtezakonshme.

14. Shperblimi per sherbimet jashte zyre si edhe shperblimi per pune te jashtezakonshme percaktohet ne raport proporcional me pagen mujore.

15. Kohezgjatja e viteve ne nje nivel page te perhershëm mund te reduktohet/ndysohet per merita te jashtezakonshme ne pune te marra gjate sherbimit sipas procedurave te percaktuara.

16. Trajtimi ekonomik i parashikuar per personelin e Policise se Shtetit shtrihet edhe per Trupen e Karabinierëve dhe trupat e tjere te parashikuar sipas pikave 1 dhe 2 te nenit 16.

17. Barazia e stafit te Policise se Shtetit me forcat e tjera sipas pikave 1 dhe 3 e nenit 16 behet sipas tabelës bashkëngjitur ligjit.

18. Shpërblimet e veçanta vendosen për ata që kryejnë veprimtari të veçante të kufizuar në kohë të shërbimit të tyre efektiv në baze të kualifikimeve dhe specializimeve.

19. Trajtimi ekonomik i personelit që ka kualifikim drejtues sipas detyrave të përcaktuara në këtë ligj dhe kategoritë e barabarta me ta janë rregulluara me Ligjin e 10 Dhjetorit të vitit 1973 nr. 804 dhe ndryshimeve të tjera dhe shtesave që i janë bërë këtij ligji.

20. Komisarëve të krahinave të Trentos dhe Bolzanos si edhe prefekteve dhe drejtuesve qendrore të Ministrisë i takon një shpërblim sipas pikës e) të këtij ligji e vlefshme edhe për periudhën kur ata janë jashtë detyre, të atashuar apo të komanduar diku tjetër. Shpërblimi është në masën 50 përqind dhe nënkuptohet për një periudhë jo më pak se pesë vjetë.

21. Për personelin e treguar në pikën e mëparshme i cili është në shërbim që nga data 25 Prill 1981 shpërblimi është në masën 50 përqind edhe pse funksionet mund të jenë ushtruar për një periudhë më pak se pesë vjetë.

22. Funksionarëve në detyrë si komisarë dhe atyre në detyrë të barabarta në Policinë e Shtetit që kanë shërbyer diku tjetër pa të meta për 15 vjetë i atribuohet trajtimi ekonomik i njëjtit me atë të drejtuesit të parë.

23. Funksionarëve në detyrë si komisarë apo strukturave të tjera të barabarta në Policinë e Shtetit si edhe drejtuesve të parë që cilet kanë shërbyer diku tjetër pa të meta për një periudhë prej 25 vitesh I atribuohet trajtimi ekonomik i njëjtit me atë të drejtuesit të lartë.

24. Personelit që kryen detyra në Administratën Civile të Brendshme, në shërbime në departamentin e Sigurisë Publike ose në zyra që varen nga autoritete kombëtare ose të krahinave si edhe personeli që punon në Administratën e Shtetit, në zyrat për koordinimin dhe planifikimin e forcave të policisë u takon një kompensim më i special i barabartë me masën 50 përqind sipas pikës së tretë të këtij neni.

25. Personelit të pikës së mëparshme i takon kompensimi për punë të jashtëzakonshme sipas procedurave dhe masave të parashikuara për strukturat e Policisë së Shtetit.

26. Derisa të mos jenë përcaktuar trajtimi ekonomik në kushtet sipas nenit 95, kompensimi më i special do të bëhet sipas parashikimeve në pikën 3 dhe Ligjin e 23 Dhjetorit të vitit 1970 nr. 1054 si edhe ndryshimet e tjera sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 43-bis.

1. Duke nisur që nga 1 shtatori i vitit 1995, personelit të forcave të policisë sipas tabelës së këtij neni i atribuohet paga sipas promovimit dhe emerimit në gradë ose kualifikim më të lartë sipas nivelit përkatës të parashikuar edhe në nenin 1 të Dekretit Legjislativ të 6 Majit 1994, nr. 271 I ndryshuar.

2. Nivelit të VII- bis që i atribuohet personelit sipas pikës 1), i korrespondon rritje prej 50 përqind parashikuar për nivelin VIII.

3. Karakteristikat, shenjat dalluese dhe gradat e strukturave të forcave të policisë sipas tabelës bashkëngjitur në këtë nen dhe të personelit me gradë të barabartë për

forcat e armatosura janë rregulluar me Dekret të ministrit kompetent në bashkëpunim me ministrat e tjere të interesuar. Derisa të hyjë në fuqi ky Dekret do të vazhdojnë të zbatohen dispozitat në fuqi për secilën strukturë të forcave të armatosura ose forcave të policisë.

Neni 43-ter

1. Për sa parashikohet në nenin 43 pikat 22 e 23, duke filluar që nga 1 Prilli i vitit 2001, funksionarëve në detyrë si komisarë dhe atyre në pozicion të barabartë në Policinë e Shtetit të cilën kanë shërbyer diku tjetër pa të meta për një periudhë prej 13 vitesh, i takon paga e Drejtuesit të Pare. Atyre me të njëjta funksione si drejtues të pare të cilët kanë shërbyer diku tjetër pa të meta për një periudhë prej 23 vitesh u takon paga e Drejtuesit të Lartë.

2. Duke nisur që nga 1 Prilli i vitit 2001, funksionarëve në detyrën e komisarëve dhe atyre të barabartë në pozicion me strukturat e Policisë së Shtetit dhe drejtuesve të pare sipas pikave 22 e 23

të nenit 43, paga parcaktohet nëse është me e favorshme në bazë të nenit 4 pika 3 e Dekret-ligjit të 27 Shtatorit 1982, nr. 681 dhe ndryshimeve të Ligjit të 20 nëntorit 1982, nr 869 sipas promovimit të kualifikimit në Drejtues të Pare dhe Drejtues të Lartë.

3. Sipas nenit 43 paragrafi gjashtëmbëdhjetë, trajtimet e referuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni do të jepen me termat dhe kushtet e njëjta dhe gjithashtu për zyrtarët Zyrtarët e forcave policore të tjera të parashikuara në nenin 16 (43).

Neni 44. Detyrimi në shërbimin e policisë

Pa rënë ndesh me rregullat e përcaktuara në Ligjin e 8 Korrikut të vitit 1980, n. 343, shërbimi ofrohet për jo më pak se dy vjet në Policinë e Shtetit, duke përfshirë edhe periudhën e frekuentimit të kurseve, nga pjesa e stafit të punësuar në detyrën e personelit të Policisë së Shtetit duke marrë parasysh çdo përmbushje të shërbimit në polici.

Kreu IV - Pranimi, edukimi dhe trajnimi i personelit

Neni 45. Kufijte e moshës

1. Për pranimin në konkurset publike për pranimin e personelit që kryen funksionet e policisë nuk zbatohen:

a) dispozitat e ligjeve përkatse mbi rritjen e kufizimit të moshës për pranimin në angazhime publike;

b) normat e parashikuara nga neni 26 të Dekret-ligjit të 30 Dhejtorit nr. 633 i ndryshuar me ligjin e 29 Shkurtit të vitit 1980 nr. 33.

Neni 46. Përshtatshmëria psiko-fizike dhe e sjelljes

Të dhënat e sigurta për përshtatshmerinë psiko-fizike dhe zotësinë e kandidatëve për konkurset për

personelin që kryen funksionet policore merren nga mjekët dhe një qender psiko-teknike e specializuar në përzgjedhjen e personelit, që i përkasin Administratës së Sigurimit Publik.

Jashtë rasteve të përmendura në paragrafin e mëparshëm, për nevoja të veçanta

Administrata e Sigurise Publike mund të marre parasysh konsulentët e organeve civile dhe ushtarake dhe profesionistët nga jashtë Administratës Derisa te zbatohet pika VI e nenit 36, per te dhenat sipas pikes se pare, Administrata Cvile e Sigurise gjithashtu mund të mbeshtetet nga mjekë ose struktura te veçanta te policisë apo forcave të armatosura.

Neni 47. Emerimi i Agjentit te Policise se Shtetit

1. Pranimi i Agjentit te Policise behet sipas procedurave te parashikuara ne urdheresen e personelit te Policise se Shtetit qe kryen funksione te policise.
2. Nuk pranohen ne konkurs ata qe jane perjashtuar nga Forcat e Armatosura, nga trupat ushtarake te organizuara ose te shkarkuar nga funksionet publike ose qe jane denuar per kryerjen e veprave te kryera pa paramendim ose u jane nenshtuar masave te sigurimit.
3. Konkursert behen me publikim/thirrje per pranimin ne sherbim ne krahina te ndyshme. Pasi marrin emerimin si agjente te policise fituesit e konkursit jane te detyruar te kryejne sherbimin ne krahinen e cila eshte caktuar me pare per peruiudhen e shprehur ne thirrjen per konkurs. Mund te jene gjithsesi nepunes te zyrave te tjera te motivuara nga nevojat per sherbim te karakterit te perkohshem.
4. Fituesit e konkursit emerohen studente -agjente te policise.
5. Konkursi kryehet per sa eshte parashikuar ne nenin 59.
6. Deri në njëzet e pesë për qind e vendeve në dispozicion në këto konkurse të referuara në këtë nen mund të jetë te rezervuar për nënoficerë, dhe ushtarake vullnetarë qe vijne nga trupat e armatosura ushtarake ose shërbimet e Marinës, aeronautikes, në pension ose në shërbim te cilet kane te paktën njëzet e katër muaj te kërkuara për sherbimin ushtarak të cilët i plotësojnë kërkesat dhe përmbushin rezultatin minimal të kërkuar
7. Vendet e rezervuara sipas pikes se meparshme te cilet nuk mbulohen, u vihen ne dispozicion kandidateve te tjere per rregjistrim sipas dispozitave eksistuese.
8. Sherbimi i kryer vullnetarisht eshte i nevojshem jo me teper se 3 vjet ne vazhdimesine e Policise se Shtetit.
9. Personeli i punësuar në pajtim me Ligjin 8 Korrikut 1980, nr. 343, qe ne kohen e pranimit kur ka bere kerkese nuk ka raportuar për sanksione më të ashpra disiplinore ndaj tij mund të ruaje për një vit tjetër titullin e ndihmes agjentit.
10. Ne fund te vitit te dyte te sherbimit, personeli qe ne kohen kur ka bere kerkese nuk ka masa dispilinore te marra ndaj tij mund te pranohet ne detyren e Agjentit te Policise pasi ka kryer nje kurs prej 6 muajsh i cili kerkon kualifikim te veçante. Gjate frekuentimit te ketij kursi personeli ruan kualifikimin e Agjentit te Policise Gjyqesore dhe atij te Sigurise Publike. Proçedura e kryerjes se kursit eshte e rregulluar me nenin 6 pika 6 bis te Dekretit te Presidentit te Republikes te 24 Prillit te vitit 1982 nr 355. Zbatohen edhe dispozitat e nenit 6 te Dekreit nr 335 te vitit 1982.

11. Në çdo rast shërbimi i ofruar tashmë nga data e rekrutimit fillestar është i vlefshëm në të gjitha efektet juridike dhe ekonomike nëse agjentet e policisë ndihmëse janë vendosur në detyre.

12. Janë fshirë paragrafët e dytë dhe të tretë të Nenit 3, L. 8 korrik 1980, n. 343.

13. Specializimet e kryera nga vullnetarët e përmendura në këtë nen në Forcën Ushtarake të origjinës njihen si të vlefshme, për aq kohë sa parashikohet në urdheresen e Policisë së Shtetit

Neni 48. Kurset për emerimin si Agjent Policie

1. Studentët-agjente të policisë ndjekin në shkollat e policisë një kurs që zgjat prej dymbëdhjetë muajsh, e ndarë në dy semestra.

2. Në fund të ciklit të parë të kursit, studentet që kanë marrë një vlerësim të përgjithshëm mbi kualifikimin në bazë të rezultateve të arritura në lëndet përkatëse dhe në provat praktike e cilesohen si të përshtatshëm në shërbimin policor emerohen agjente në prove dhe pranohen për të frekuentuar semestrin e dytë gjatë të cilit i nënshtrohen seleksionimit për pranimin në shërbime që kërkojnë kualifikim të veçantë.

3. Agjentet në prove të cilët kanë kaluar provimet teorike-praktike në fund të kursit dhe kanë marrë konfirmimin për të qenë të përshtatshëm në shërbimin e policisë emerohen agjente të policisë. Ata bëjnë betimin dhe vendosen në detyrë sipas rezultateve të renditjes finale.

4. Agjentet e proves që cilët nuk e kanë kaluar provimet në fund të kursit por që janë gjykuar si të përshtatshëm për të shërbyer në polici janë pranuar për të perseritur jo më shumë se një herë semestrin e dytë. Në fund të semestrit të dytë pranohen perseri në provimet finale sipas procedurave të parashikuara në rregullore sipas pikës së parafundit të nenit 60. Në rast të rezultatit negativ ata përjashtohen nga kursi.

5. Studentet dhe agjentet në prove për të gjithë kohezgjatjen e kursit nuk mund të jenë nepunës në shërbimet e policisë përfshirë edhe shërbimet në kazerme.

Neni 49. Shkarkimi nga kurset për emerimin si agjent policie

1. Shkarkohen nga kursi:

1) Studentet që nuk kalojnë ciklin e parë;

2) Studentet dhe agjentet e policisë që nuk janë vlerësuar si të përshtatshëm për shërbimin në polici;

3) Studentet dhe agjentet e policisë në prove që deklarojnë që do të heqin dorë nga kursi;

4) Studentet dhe agjentet e policisë në prove që kanë munguar për çdo lloj motivi në kurs për më shumë se 60 ditë edhe pse jo të njëpasnjëshme ose për më shumë se 90 ditë si pasojë e sëmundjes së marrë gjatë kursit, nëse sëmundja është marrë si pasojë e ushtrimeve praktike, studenti apo agjenti në prove pranohet të marrë pjesë në kursin e parë pas përshtatshmerisë fizike-psikike.

5) Agjentet në prove sipas pikës së 4 të nenit të mëparshëm.

2. Studentet dhe agjentet në prove të seksit femer, për të cilat mungesa 60 ditë vjen

si pasoje e shtatzanise pranohen te marrin pjese ne kursin e pare pasues ne periudha mungesash ne pune te parashikuara sipas dispozitave per mbrojtjen e punetoreve nena.

3. Perjashtohen nga kursi studentet dhe agjentet ne prove qe jane pergjegjes per kundrvatje te ndershkuar me sanksione disiplinore

4. Parashikimet e perjashtimit nga kursi jane miratuar me dekret te Shefit te policise, Drejtorit te Pergjithshem te Sigurise Publike mbi bazen e propozimit te Drejtorit te Shkolles.

5. Perjashtimi nga kursi sjell si pasoje nderprerjen e te gjitha marrdhenieve me administraten

Neni 50. Trajnime dhe kurse specializimi per agjentet e policise.

1. Agjentet e policise kryejne nje periudhe trajnimi praktik prej nje kohe prej 6 muajsh ne repartet dhe zyrat ne te cilat caktohen duke marre parasysh rezultatet e seleksionimit te kryer ne 6 mujorin e dyte sipas nenit 48.

2. Per agjentet te cilet ne baze te seleksionimit dhe raportit mbi aftesite profesionale te nxjerre nga Pergjegjesi i Repartit ose nga Drejtuesi i Zyres prane te ciles ata jane caktuar duhet t'i nenshtrohen specializimeve ose sherbimeve te vecanta, kualifikimeve apo kurse per nje periudhe prej 6 muajsh.

3. Agjentet te cilet frekuentojne kurse specializimi nuk mund te angazhohen ne aktivetete te ndryshme nga sherbimi ne te cilin jane caktuar vetem ne rast te domosdoshmerise se sherbimit me leje te Drejtuesit te Policise-Drejtorit te Pergjithshem te Sigurise Publike. Kur kjo si pasoje sjell nderprerjen e kursit per nje periudhe prej 30 ditesh, atehere kursi zgjatet per nje periudhe te barabarte me ate te nderprerjes,

Neni 51. Emerimi si Mbikqyres i Policise

1. Konkursi i brendeshem dhe kursi I formimit teknik-profesional per hyrjen ne detyren e Mbikqyresit kryhet sipas procedurave te parashikuara ne paragrafin e trete te nenit 59 dhe atij te parafundit te nenit 60.

Articolo 52. Emerimi i studentit si inspector policie

1. Pranimi i inspektoreve te policise behet me konkurs publik ne te cilin marrin pjese qytetaret italiane qe gezojne kriteret e meposhtme:

1) gezojne te drejta civile dhe politike;

2) te jene jo me pak se 18 vjeç dhe jo me shume se 32 vjeç;

3) te kene pershtatshmeri fizike dhe psiqike si edhe zotesi ne sherbim te policise;

....4) diplome te shkolles se mesme ose diplome ekuivalente me te;

5) te kene sjellje te mire.

2. Ne konkurs pranohen gjithashtu te marrin pjese per jo me shume se dy here ne nje te gjashten e vendeve, punonjesit e policise qe kane te pakten 3 vjet eksperience ne sherbim efektiv nga data e thirrjes per konkurs, qe gezojne kriteret e siperpermendura me perjashtim te kriterit te moshes. Nese vendet e rezervuara nuk mbulohen atehere keto vende kalojne per kategorine tjeter.

3. Barazia e meritave per punonjesit e policise perben titull preferencial duke kaluar titujt e tjere preferenciale te parshikuara nga ligjet ne fuqi.
4. Nuk pranohen ne konkurs te gjithe ata qe jane perjashtuar nga forcat e armatosura, trupat ushtarake, ose te shkarkuar nga detyrat publike qe jane te denuar per vrasje pa paramendim ose u jane nenshtuar masave ndaluese.
5. Relativisht persa i perket konkursit dhe provimit sipas ketij neni zbatohen edhe kerkesat e nenit 59
6. Fituesit e konkursit emerohen studente-inspektore.

Neni 53. Kurset per emerimin si Inspector Policie

1. Sapo marrin emerimin, studentet-inspektore te policise frekuentojne prane Institutit nje kurs me kohezgjatje prej 18 muajsh i cili ploteson formimin tekniko-profesional te Agjentit te Sigurise Publike e Oficereve te Policise Gjyqesore qe perqendrohet vecanerisht ne veprimet hetimore. Gjate kursit I nenshtrohen edhe perzgjedhjes per aftesite e pershatshmerise ne sherbime te cilat kerkojne kualifikim te vecante.
2. Studentet- inspektore qe vleresohen te pershtatshem per sherbimin ne Polici dhe ata inspektore qe kalojne provimet me goje dhe shkrim dhe provat praktike ne fund te kursit, emerohen inspektore ne prove. Ata bejne betimin dhe vendosen ne detyre sipas rezultateve finale ne konkurs.
3. Studentet-inspektore gjate 12 muajve te para te kursit nuk mund te angazhohen ne sherbim te Policise Ne periudhen pasardhese mund te angazhohen ekskluzivisht vetem ne fund te trajnimit ne sherbimin e inspektorit dhe per nje periudhe jo me shume se 2 muaj.
4. Inspektoret ne prove caktohen sipas rezultateve te aftesise ne sherbim te Institutit per te permbushur nje periudhe prove qe zgjat 6 muaj.

Neni 54 Perjashtimi nga kursi per emerimin Inspektor Policie.

1. Perjashtohen nga kursi studentet inspektore qe:
 - a) Nuk kalojne provimet e kursit ose deklarohen si jo te pershatshem per sherbimin policor;
 - b) Deklarojne terheqjen nga kursi;
 - c) Oer çdolloj motivi mungojne ne kurs per me shume se 90 dite edhe pse jo te njepasnjeshme dhe 120 dite nese mungesa ka ardhur si pasoje e nje semundje te marre gjate kursit si pasoje e ushtrimeve praktike. Ne rast te tille studenti pranohet te marre pjese ne kursin e pare pasues sapo konfirmohet se eshte i pershtatshem.
2. Studentet-inspektore per te cilat mungesa pertej 90 diteve vjen si pasoje e lejes se lindjes pranohen per te marre pjese ne kursin e pare pasues per periudhat e mungeses ne pune sipas parashikimeve te mbrojtjes se punetoreve nena.

3. Perjashtohen nga kursi studentet qe jane pergjegjes per kryerjen e kundravatjeve te denueshme me sanksione disiplinore .

4. Parashikimet e shkarkimit dhe perjashtimit nga kursi jane miratuar me dekret te Drejtuesit te Policise-Drejtorit te Pergjithshem te Sigurise Oublike me propozim te Drejtorit te Institutit.

5. Shkarkimi nga kursi sjell si pasoje perfundimin e te gjitha marredhenieve me administraten pervecse kur nuk vjen nga detyrat ne strukturen e Policise se Shtetit.

Neni 55. Emerimi si Komisar Policie

1. Pranimi si Komisar Policie behet:

a) pasi ka frekuentuar me rezultate positive Institutin e Larte te Policise sipas nenit 58;

b) me konkurs publik ne te cilin marrin pjese te gjithe qytetaret italiane qe plotesojne kekesat e meposhtme:

1) gezojne te drejta civile e politike;

2) pershtatshmeri fizike e psikike dhe aftesi per sherbim ne polici;

3) sjellje te mire;

4) diplome ne drejtesi ose ne shkenca politike;

5) te jete jo me shume se 32 vjeç.

2. Ne konkurs pranohen gjithashtu te marrin pjese dhe per te cilet eshte rezervuar nje e pesta e vendeve ne dispozicion edhe atyre qe u perkasin detyrave te agjentit dhe asistentit dhe te mbikqyresit qe kane te pakten 3 vjet experience qe nga data qe eshte shpallur konkursi si edhe atyre qe plotesojne kerkesat e pershkruara me siper me perjashtim te kufizimit te moshes. Ne rast se keto vende nuk mbulohen u shtohen vendeve te kategorise tjeter. Merren parasysh kerkesat e pikes se pare per pjesemarrsit ne konkursin per detyra ne Administraten e Brendshme Civile qe jane jo me sh se 38 vjeç.

Ne konkurs nuk pranohen ata qe jane perjashtuar nga forcat e armatosura, nga trupat ushtarake ose te shkaruar nga detyrat publike qe jane denuar per vepra penale te kryera pa paramendim o u nenshtrohen masave parandaluese.

4. Kandidatet u nenshtrohen provave te pershtatshmerise fizike dhe psikike dhe provave per pershtatshmerine ne cilesite e duhura per sherbimin policor.

5. Fituesit e konkursit emerohen komisare ne prove.

6. Per konkursin zbatohet ajo çka eshte e parashikuar ne nenin 59.

Neni 56. Kursi per emerimin e Komisarit te Policise

1. Sapo merr emerimin, Komisari ne prove frekuenton nje kurs formimi teoriko-praktik qe zgjat 9 muaj prane Institutit te Larte te Policise sipas nenit 58.

2. Kursi i formimit kryhet sipas programeve te parashikuara me dekret te Ministrit te Brendshem dhe me mesimdhenein e docenteve universitare, magjistrate, punonjes te administrates ose persona te jashtem te saj.

3. Ne perfundim te kursit komisarët ne prove qe deklarohen te pershtatshem per sherbimet e policise zhvillojne nje provim final mbi lendet e studimit perpara nje komisioni te perbere sipas procedurave te parashikuara ne piken e parafundit te nenit 60 dhe te kryesuar nga Drejtori i Institutit te Larte te Policise.

4. Komisarët e policise pergjate 9 muajve te kursit nuk mund te angazhohen ne sherbimet policore.

5. Komisarët ne prove qe kalojne provimet finale te kursit emerohen komisarë policie.

6. Ata bejne betimin dhe pranohen ne detyra drejtuese sipas renditjes ne provimin final.

7. Komisarët ne prove qe nuk kalojne provimin final mund te marrin pjese ne kursin pasues, Ne rast se rezultatet e ketij te fundit jane negative ata shkarkohen.

8. Ne baze te rezultateve dhe perzgjedhjes se aftesive, komisarët caktohen ne sherbim te Institutit.

Neni 57 Shkarkimi nga kursi per emerimin si komisar policie

1. Shkarkohen nga kursi komisarët ne prove qe:

a) deklarojne se heqin dore nga kursi;

b) nuk kalojne provimet e kursit;

c) nuk jane deklaruar si te pershtatshem per sherbimin policor per shkak ne numrit dhe shkalles se sanksioneve disiplinore;

d) mungojne per çdo lloj motiv per me shume se 30 dite nga kursi edhe pse jo te njepasnjeshme ose per 90 dite si pasoje e semundjeve te marra gjate kursit si rezultat i ushtrimeve praktike. Ne rast te tille komisarë ne prove pranohet per te marre pjese ne kursin e pare pasues qe nga momenti i konfirmimit te pershatshmerise psikiko-fizike.

2. Komisarët ne prove te seksit femer per te cilat mungesa mbi 30 dite ka ardhur si pasoje e lejes se lindjes per periudhat e mungeses ne pune dhe te mbrojtjes se punonjeseve nena.

3. Perjahtohen nga kursi komisarët ne prove qe jane pergjegjes per kundravajtje te denueshme me sanksione administrative.

4. Parashikimet e shkarkimit dhe perjashtimit nga kursi miratohen me dekret te Drejtuesit te Policise –Drejtorit te Pergjithshem te Sigurise Publike me propozim te Drejtorit te Institutit te Larte te Policise.

Neni 58. Instituti i Larte i Policise

1. Qeveria e Republikës duhet te parashikojë brenda 12 muajve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji me dekret qe ka fuqine e ligjit ngritjen e nje institucioni te larte me qender ne Rome per formimin dhe specializimin e kuadrit drejtues te Administrates se

Sgurise Publike qe merr emrin e Institutit te Larte te Policise sipas parimeve dhe kritereve drejtuese si vijojne:

a) Parashikimin qe pranimi ne konkurs per hyrjen ne Institut qe jete I hapur per te rinjte qe kane nje diplome te shkolles se mesme ose nje titull ekuivalent dhe qe kane kaluar moshen 21 vjeç dhe qe permbushin kerkesat e tjera te parashikuara nga neni 55.

b) Vendosjen e procedurave te konkursit te pranimit, te perberjes dhe emerimit te perberjes se komisionit te provimit, te kritereve te pershtatshmerise fizike dhe psikike, te vleresimit te cilesive te aftesise dhe te nivelit kulturor te kandidatit.

c) Parashikimin qe ne konkursin e hyrjes mund te marrin pjese inspektoret, mbikqyresit, asistentet dhe agjentet qe permbushin kriteret e parashikuara dhe qe nuk kalojen moshen 30 vjeç.

d) parashikimin qe kursi zhvillohet sipas programeve universitare me lende profesionale sipas planeve mesimore per çdo lende te parashikuar me dekret te Ministrin te Arsimit Publik ne bashkepunim me Ministrin e Brendshem.

e) Parashikimin qe ne perfundim te dyvjecarit te pare studentet marrin emerimin per aspirant te komisarit te policise ne prove pas marrjes se vleresimit per pershatashmerine nga Drejtori i Institutit pasi ka marr me pare mendimin e kolegjit te dcenteve.

f) Parashikimin qe ne perfundim te vitit te katert te kursit studenti qe ka kaluar te gjitha provimet e parashikuara ne planin mesimor, pranohet per te dhene provimin final perpara nje komisioni te perbere nga docente te lendeve universitare dhe profesionale te Institutit te kryesuar nga Presidenti i Universitetit te Fakultetit Juridik te Universitetit te Romes ose nga nje docent univeristar I deleguar prej tij, dhe qe komisioni emerohet çdo vit me dekret te Ministrin te Arsimit Publik ne bashkepunim me Ministrin e Brendshem.

g) Parashikimin qe pasi marrin diplomen aspirantet emerohen komisare ne prove dhe pranohen per te ndjekur kursin sipas pikes se pare te nenit 56 prane nje seksioni te veçante te Institutit.

h) Ngritjen e stukturave te Insitiutit duke parashikuar krijimin e tre seksioneve nga te cilat nje per permbushjen e nevojave sipas nenit 56 dhe nje per kurset e specializimit.

i) Vendosjen e procedurave per te garantuar detyrimin kundrejt administrates te emerimit te studentit per te vazhduar sherbimin per 5 vjete nga marrja e diplomes si edhe per largimin dhe shkarkimin e studenteve aspirante nga kurset.

I) Parashimin e normave per kryerjen e provimeve integruese dhe diplomes.

Neni 59. Trajtimi ekonomik i studenteve dhe procedurat e konkurseve.

1. Trajtimi ekonomik i studenteve ne kurse sipas neneve te meparshme eshte vendosur ne mase proporcionale me pagesen ne baze te kualifikimeve fillestare ne lidhje me kurset perkatese me dekret te Ministrin te Brendshem ne bashkepunim me Ministrin e Thesarit.

2. Studenteve qe vijne nga detyra te tjera ne Policine e Shtetit i caktohet trajtimi ekonomik me i favorshem.

3. Proçedurat e konkurseve, te perberjes dhe emerimit te komisioneve te provimeve dhe kritereve te pershtatshmerise fizike dhe psikike, per vleresimin e aftesive dhe nivelin kulturor te kandidateve, per dokumentacionin dhe kerkesat e duhura per pranimin ne konkurs miratohen me dekret te Presidentit te Republikes pas miratimit te Keshillit te Ministrave me propozim te Ministririt te Brendshem.

Neni 60. Trajnime dhe kualifikime profesionale

1. Institucionet për trajnimin dhe formimin e efektivit të Policisë së Shtetit janë si më poshtë:

1) shkolla për agjentët e policisë;

2) instituti për drejtuesit e policisë;

3) institute për rritjen profesionale të inspektorëve të policisë;

4) Akademia e lartë e policisë;

5) qendra dhe shkolla për specializimin, stërvitjen dhe refreskimin e njohurive.

2. Programet i kanë kushtuar kujdes të veçantë njohjes me Kushtetutën dhe të drejtave dhe detyrimeve të njeriut, njohjes me materialet ligjore dhe ato të fushës si dhe ndjekjes së praktikave që luftojnë krimin si dhe sigurojnë rendin dhe sigurinë publike.

3. Hartimi programeve, metodave pedagogjike, raporti mësues-nxënës, ekzistenca dhe dhënia e praktikës I shërbejnë përgatitjes sa më të lartë profesionale të personelit dhe promovojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe marrjes së iniciativës.

4. Përveçse parashikohet në Institutin e lartë të policisë, përfshi institucionet e sipërpërmendura, të cilët siç edhe është sipërpërmendur në paragrafin e parë, mund të përdoren për të kryer trajnime me anë të pedagogëve të universiteteve ose të institucioneve më të specializuara, jo mësues të shkollave të mesme dhe tetëvjeçare, përveç rasteve kur lëndët që mësojnë në shkollat e tyre korespondojnë me ato që mësohen në vetë shkollat, të përfshira në disa nga listat e hartuara për secilën shkollë apo qendër policie, bazuar tek emrat e përzgjedhura sipas disiplinës ku ka interes policia, si p.sh magjistratët, funksionarë të Policisë së Shtetit apo organeve të tjera të administratës publike, zyrtarë të Forcave të Armatosura si dhe ekspertë të një discipline të

Caktuar, të cilët kanë konfirmuar më parë disponueshmërinë e tyre kreut të institucionit apo shkollës së policisë.

5. Për mësimdhënien e lëndëve të specializuara-profesionale dhe ato operationale, I janë caktuar si detyrë personelit të nivelit drejtues, komisarëve dhe inspektorëve të Policisë së Shtetit; stërvitjen fizike, teknike-operationale mund ta kryej çdo efektiv policie i çdo roli i pajisur me çertifikatën e instruktorit dhe që ka kualifikimin e duhur si dhe është ekspert i fushës. Kur ka nevoja për kontigjent policie, këty detyra mund t'i atribohen edhe pjesës tjetër të personelit të Policisë së Shtetit, përfshirë institucionet e interesuara të cilët kanë kualifikimin e duhur, me gradë jo më të ulët se kryeinspektor apo të një niveli ekuivalent. Detyrat janë të vlefshme gjatë jetëgjatësisë së kursit dhe janë të rinovueshme. Zgjedhja e lektorëve I takon Ministrisë së Brendshme, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së rendit publik si dhe të drejtorit të institucionit të shkollës ose qendrës së policisë. Lektorët që nuk kanë rol në shkollën e trajnimeve dytësore, të ngarkuar për mësimdhënie në shkollën ose qendrën e policisë, nëse janë të emëruar në listën vjetore nga drejtuesi departamentit së arsimit, mund të autorizohen nga drejtuesi

institucionit të kryejnë trajnim pranë këtij institucioni në Policinë e Shtetit, përsa kohë orari mësimdhënies të mos kalojë tetëmbëdhjetë ore në javë dhe të jetë në përputhje me aktivitetet e mësimdhënies që duhet të kryej një lektor jashtë rolit në insitucionet dytësore të trajnimit, përfshi institutin, shkollën ose qendrën e Policisë dhe që konsiderohet si shërbim jashtë detyre që ofrohet nga shkollat shtetërore.

6. Ata që emërohen për të kryer aktivitete mësimore mund të caktohen, me përjashtim të personelit që kryen rol në policinë e shtetit, në pozicionet në dispozicion të administratës ku punojnë dhe në këtë rast do të kryejnë me kohë të plotë aktivitetin e mësimdhënies. Mësuesit e lëndëve të përgjithshme që janë në shërbim në shkollat e policisë që nga data e hyrjes në fuqi më 11 Qershor 1974, n. 253, të emëruar për mësimdhënie si dhe sipas nenit 1 dhe 3 të 27 Tetorit 1975, n. 608, mbeten me kërkesë në pozicionet aktuale dhe do të ushtrojnë funksionin e tyre deri në momentin e daljes në pension.

7. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e pestë, për stërvitjen fizike dhe teknike-operacionale brenda institutit, shkollës apo qendrave në varësi të Administratës së sigurisë publike, bëhet pagesa e orëve shtesë siç paraashikon neni 13 i D.P.R. 21 Prill 1972, n. 472, për shkollën e lartë të administratës publike.

8. Materialet mësimore, planet e studimit, zhvillimi kurseve, kryerja e provimeve, mësuesit dhe format e organizimit dhe bashkëpunimit midis mësuesve dhe nxënësve janë parashikuar në rregulloren e institutit, shkollës ose qendrës, të cilët siç edhe përmendet në paragrafin 1, lëshohen me dekret të Ministrit të Brendshëm.

[9. Bordi akademik i shpreh mendimin drejtorit nëse gjykon se zgjedhja është e përshtatshme sipas nenit 48, paragrafi dytë, 53, paragrafi dytë dhe 56, paragrafi tretë.

Neni 61. Qasja për rolet që janë të ndryshme nga ato që kryejnë funksionin e policisë

1. Qasja për kualifikimin fillestar të roleve që kryejnë aktivitetet tekniko-shkencore apo teknika të një karakteri ekzekutiv që lidhen me rolet e policisë dhe me personelin që kryen detyra të një natyre profesionale që lidhen me policinë dhe për ushtrimin e këtyre të fundit është i nevojshëm regjistrimi në strukturat profesionale, të cilat mundësohen nëpërmjet konkurseve publike, për të cilat janë të lejueshëm nënshtetasit Italian që janë të pajisur me diplomën përkatëse dhe kushtet e nevojshme profesionale.

2. Kjo vihet në zbatim sipas Nenit 59.

3. Emërimi në këto role të fituesve të konkursit është në varësi alia të detyrës që kërkohet për kursin e formimit dhe është e zbatueshme me qëllim që të ketë përgatitjen e nevojshme për detyrat që do të kryejë, me rëndësi të veçantë funksioneve që lidhen me policinë.

Neni 62. Premtimi solemn dhe betimi

1. Nënshtetasit që bëhen pjesë e Administratës së Rendit Publik duhet të kryejnë premtimin solemn dhe betimin sipas Nenit 11 të dispozitave që lidhen me statusin e nënpunësve civil, miratuar nga D.P.R. më 10 Janar 1957, n. 3.

2. Refuzimi për ta kryer sjell dhe sjell dhe mosmarrjen e vendit të punës.

Kapitulli V – Të drejtat dhe detyrat

Neni 63. Orët e shërbimit

Orët e shërbimit për personelin e sigurisë publike janë dyzet orë në javë, të ndara

sipas turneve ditore në varësi të shërbimit. Për një periudhë tre vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji turnet ditore të punës do të plotësojnë kuotë dyzet e dy orë në javë. Ndryshimi i orëve i caktuar në paragrafin e parë dhe atij të dytë do të konsiderohet si orë shtesë pune.

Kur kërkohen detyrë shtesë nga zyrtarët, agjentët e sigurisë publike dhe personeli që përmbush detyrat në administratën e sigurisë publike do t'i kryejnë këto detyra edhe jashtë orarit zyrtar të punës kundrejt pagesës së orëve shtesë sipas kushteve të parashikuara në Dekretin e Presidentit të Republikës, i 22 Korrikut 1977, n. 422, për personelin me kualifikime të ndryshme nga ato të drejtuesve, në nenin 20 të Dekretit të Presidentit të Republikës më 20 Korrik 1972, n. 748 dhe ligjit të 22 Korrikut 1978, n. 385, "Për personelin në pozicion drejtues". Legjislacioni që I referohet këtij neni është i zabtueshëm edhe për drejtuesit e përgjithshëm dhe ata me kualifikime ekuivalente deri në hyrjen në fuqi të një ligji të ri që lidhet me funksionin e posteve drejtuese.

Personeli I përmendur në paragrafin e parë është pjesa civile e administratës së Ministrisë së Brendshme, personeli që ofron shërbime në fushën e sigurisë publike dhe kanë të drejtë për një ditë pushim në javë. Për nevoja urgjente pune kur kjo ditë pushimi nuk mund të kryhet brenda harkut javor, ka të drejtë të merret brenda katër javëve në vijim.

Personeli të cilit i referohet paragrafi i parë, i cili punon në ditët e festave, jo të ditëve të diela, ka të drejtën të gëzojë një ditë pushim, të caktuar nga administrata, brenda katër javëve në vijim.

Neni 64. Detyrimet e përhershme dhe gatishmëria

Për arsye të rendit dhe sigurisë publike ose për nevoja të publikut mund të jetë e detyrueshme për efektivin e Policisë së Shtetit të qëndrojnë në kazermë ose zyra, të jenë në gatishmëri sipas pikave të përcaktuara në rregulloren e shërbimit, përkatësisht neni 111 (19/b).

Personeli që kryen funksione të policisë ka për detyrë të qëndrojnë në institucione ose reparte gjatë kurseve ose periudhës së trajnimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni dhe rregulloret përkatëse të përmendua në paragrafet e mësipërme. Për mbajtjen hapur të mensave, të cilat nuk kanë të detyrueshëm shërbimin do të caktohet një shumë e cila është në përputhje me numrin e forcave të armatosura të Shtetit.

Neni 65. Kompetencat e vartësisë

Personi që luan rol në administratën e sigurisë publike ka vartësi hierarkike nga:

- a) Ministri i Brendshëm;
- b) Sekretari i shtetit për punët e brendshme, kur ju delegohen me autorizim të Ministrisë kompetenca në fushën e sigurisë publike;
- c) nga drejtori përgjithshëm i policisë për sigurinë publike.

Mbeten të njëjta funksionet e vartësisë së funksionarëve të administratës së sigurisë publike në lidhje me prefektin, për ato raste të parashikuara nga ligji, ndaj autoriteteve të tjera Shtetërore.

Neni 66. Varësia hierarkike dhe linjat e raportimit

Stafi i administratës së sigurisë publike do të ndjek urdhrat e eprorit hierarkik ose operacional.

Urdhrat duhet të jenë në përputhje me shërbimin ose disiplinën alia, të mos tejkalojnë kompetencat e institucionit dhe të mos shkelin dinjitetin personal të personave të përfshirë.

Stafi i administratës së sigurisë publike, të cilit i është dhënë një urdhër dhe ky i fundit mendon se është i paligjshëm, duhet t'ia raportojë menjëherë me arsyet përkatëse eprorit që e ka lëshuar këtë urdhër; nëse urdhri është dhënë me shkrim duhet të përgjigjet në të njëjtën formë eprorit që e ka lëshuar.

Kur stafi i policisë së shtetit është në shërbim të rendit dhe sigurisë publike, në një situatë të menjëhershme rreziku, në rast se konsideron se urdhri i dhënë është i paligjshëm mund t'ia komunikoj edhe në formë verbale eprorit, i cili në fund të shërbimit ka detyrën ta konfirmoj me shkrim.

Stafi i administratës së sigurisë publike, të cilit i jepet urdhër, ekzekutimi i të cilit është një shkelje e dukshme, nuk do ta zbatoj dhe për këtë do të informoj menjëherë eprorët.

Dispozitat e paragrafit të mësipërm janë të zbatueshme, sa herë është nevojshme, për raportet e vartësisë që rrjedhin nga sistemi i ri i sigurisë publike.

Stafi i policisë së shtetit, pjesa civile e administratës, ashtu si forcat e tjera të policisë së shtetit dhe administratës publike do të ndjekin të njëjtat dispozita që janë lëshuar për funksionin përkatës nga niveli qendror dhe vendor i administratës së sigurisë publike.

Sipas dispozitave të neneve 13 dhe 14, personelit me rol komisar dhe drejtues në policinë e shtetit ju transferohen atributet si funksionar të sigurisë publike.

Mosrespektimi i dispozitës së nenit përkatës do të çoj në marrjen e masave disiplinore dhe deri në ndjekje penale.

Neni 67. Punësimi i efektivit të policisë së shtetit

Punonjësit e policisë së shtetit nuk mund të angazhohen në detyra që nuk i shërbejnë misionit të institucionit.

Neni 68. Detyrimet jashtë shërbimit për punonjësit e administratës së sigurisë publike

Punonjësit e Administratës së sigurisë publike, edhe kur nuk janë në shërbim, duhet të jenë gjithmonë në gatishmëri të respektojnë detyrat që ju kërkon funksioni i tyre.

Neni 69. Asistenca fetare

Personeli i Policisë së Shtetit që dëshiron të marrë pjesë në shërbime fetare në komunitet ose shkolla, do t'i mundësohet kjo kërkesë në përputhje me Kushtetutën. Nga asistenca fetare përjashtohen funksionarët fetarë që punojnë në ushtri.

Kapitulli VI – Masat disiplinare dhe penale

Neni 70. Disiplina dhe ndjekja disiplinore

Qeveria e Republikës duhet të parashikoj, brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktimin e sanksioneve disiplinore për personelin e Administratës së Sigurisë Publike dhe të rregulloret zbatuese për ndjekjen e tyre, më theks të veçantë parimeve dhe kritereve të mëposhtme:

- 1) vlerësimet e masave disiplinore do të ndjekin rendin: paralajmërim me gojë, paralajmërim me shkrim, gjobë, mosngritje në detyrë, pezullim nga detyra, pushim nga puna;
- 2) masat për secilën prej veprave sipas dënimit të vendosur, shkalla e ashpërsisë së ndëshkimit do të jetë në përputhje inter alia me nivelin e shkeljes, dhe duke pasur parasysh specifikat e shërbimit;
- 3) ndëshkimi me gjobë nuk duhet të ketë vlerë që kalon 5/30 e pagës mujore dhe mundësinë për ta zëvendësuar atë, për studentët e institucionit të trajnimit, do të mbeten në institut për një periudhë që nuk kalon pesë ditët;
- 4) në rastet e parashikimit të mosngritjes në detyrë, kombinuar më gjobë të vogël, nuk do të ketë rritje vjetore të rrogës dhe as kalim në kategorinë e pagave maksimale;
- 5) kur parashikohet që pezullimi nga puna të mos zgjas më shumë se gjashtë muaj, do të zbritet vjetërsia, heqja e pagës mujore, si dhe një vonesë deri në tre vjet për rritje në detyrë ose rritje page si dhe për të kaluar në kategorinë e pagave të larta;
- 6) kur parashikohet se pushimi nga puna është pasojë e sjelljeve të përsëritur dhe të njëjtë e cila bie ndesh me detyrat dhe kërkesat dhe shërbimet e policisë, e cila është e papajtueshme me përgjegjësitë e administratës së sigurisë publike; parashikimi për heqjen e të drejtës si dënim përfundimtar për shkelje të rënda të qëllimshme, pezullim qoftë edhe të përkohshëm nga funksionet publike ose zbatimi i një mase sigurie ose parandaluese;
- 7) rregullimi procedurës për zbatimin e masave disiplinore sipas sipas kritereve vijuese: përcaktimi organeve kompetente që do të zbatojnë sanksionin: detyrimi për dhënien e motiveve; organi interesuar për të apeluar sanksionin e dhënë; përcaktimi organeve për rishikimin e sanksioneve dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme verifikuese; parashikimi organeve të natyrës kolegjiale për sanksionet më të rënda që parashikojnë dënim në të holla; prania në këto organe nga një përfaqësues i sindikatave të policisë; të jepet e drejta për të argumentuar; organi gjykimit për sanksionet më të rënda kundërshtuese, do të asistohet nga një punonjës i administratës së sigurisë publike që do të luaj rol in e mbrojtësit; masa parashikuese që gjykimi për shkeljet që çojnë në masën disiplinore të pezullimit nga shërbimi si dhe të pushimit nga puna, të kryhet nga epror që kryejnë shërbim të ndryshëm nga ai i punonjësit që po hetohet;
- 8) parashikime që, në rast se do të ketë ndjekje disiplinore që lidhet me ndjekje penale, personi do të qëndrojë i pezulluar me masën e parë derisa të merret vendimi i formës së prerë në masën e dytë; parashikimi për raste pezullimi paraprak nga detyra deri në pritje të procedimit penal;
- 9) parashikimi për rastet e rihapjes së procedurave disiplinore;

10) parashikimi i masave tranzitore për kalimin e çështjes tek organet e reja disiplinore për procedurat që janë në pritje deri në futjen në fuqi të masave të deleguara.

Neni 71. Juridiksioni

Punonjësit e administratës së sigurisë publike janë subjekt i juridiksionit penal në rrethin përkatës gjyqësor, sipas ligjeve në fuqi si dhe atyre të përfshira në nenet vijuese.

Neni 72. Braktisja e vendit të shërbimit

Punonjësi i policisë së shtetit, cili gjatë një operacioni policie apo gjatë kohës që po kryen shërbim, braktis postin ose shërbimin, ose shkel urdhrin apo instruksionet e përgjithshme ose ato me rëndësi të veçantë, do të dënohet deri në tre vjet burg.

Burgimi zgjat nga një deri në katër vjet nëse është kryer:

- 1) gjatë shërbimit të rendit publik ose urgjencave publike;
- 2) gjatë kohës që ka në ruajtje materiale të aviacionit, magazinat e armëve, municione, materiale djegëse ose shpërthyes;
- 3) në bord të anijes ose avionit;
- 4) ndërprerja e vazhdimit ose rendit të shërbimit;
- 5) nga tre ose më shumë punonjës së policisë së shtetit në konkurrencë me njëri tjetrin;

6) nga komandanti një reparti ose nga drejtuesi i një zyre apo shërbimi.

Nëse ky veprim sjell ndërprerjen e shërbimit dhe dëme të rënda, dënimi me burgim do të jetë nga dy në pesë vjet.

Neni 73. Revoltat

Përveç rastit të parashikuar në nenin 284 të Kodit Penal, do të dënohen me burg nga tre deri në dhjetë vjet ata punonjës së policisë së shtetit, të grumbullohen nga pesë punonjës ose më sipër:

- 1) marrin në formë arbitrare armët dhe refuzojnë t'i binden urdhrin për t'i kthyer, të lëshuar nga një epror;
 - 2) refuzojnë t'i binden urdhrin të eprorit që të tërhiqen nga aktet e rënda të dhunës.
- Dënimi për atë që ka nxitur, organizuar dhe drejtuar revoltën nuk do të jetë më pak se pesë vjet burgim.

Neni 74. Kryerja e veprës penale të revoltës

Kur pesë ose më shumë punonjës së policisë së shtetit grupohen për të kryer veprën penale të revoltës, nëse vepra nuk është kryer ende, dënimi me burg do të jetë nga një deri në katër vjet. Nuk dënohen ata që ndalojnë kryerjen e veprës penale.

Neni 75. Përfshirja e paautorizuar në repart

Komandanti i një reparti organik policie, i cili pa ju ngarkuar detyra ose pa qenë e nevojshme, shkel rregulloren e repartit dhe urdhëron lëvizje në repart do të dënohet me një vit burg, gjithmonë në rast se ky veprim nuk do të sjell pasojat më të rënda.

Neni 76. IVI manifestimet kolektive duke përdorur mjetet ose armët e policisë

Punonjësit e administratës së sigurisë publike që kryejnë manifestime kolektive publike duke përdorur mjetet e policisë do të dënohen me deri në gjashtë muaj burg ose me gjobë prej nga pesëqind mijë deri në një milion lireta.

Dënimi rëndohet deri në nëntë muaj, gjoba arrin deri në 1 milion e gjysëm liretaa për ata që kanë nxitur, organizuar dhe drejtuar manifestimin. Punonjësit e administratës së sigurisë publike që marrin pjesë në manifestim me armë do të dënohet nga gjashtë muaj deri në dy vjet burg.

Neni 77. Ndryshimi i armëve ose municioneve, mbajtja e armëve të pambushura

Punonjësit e Policisë së Shtetit që ndryshojnë në çdo lloj mënyre karakteristikat e armëve të tyre ose municioneve me të cilat janë pajisur apo që mbajnë armë të ndryshme nga ato që ju janë dhënë do të dënohen me deri tre vjet burg dhe gjobë që shkon deri në dy milion lireta.

Subjekt i të njëjtit dënim do të jetë edhe eprori hierarkik që i miraton veprat e parashikuara në paragrafin e mësipërm.

Neni 78. Ofrimi arbitrar i shërbimeve të punës

Përveç rasteve kur kjo vepër përbën një shkelje të rëndë, nëpunësi zyrtar që ofron në mënyrë arbitrare shërbimet e punës së administratës së sigurisë publike, në kundërshtim me rregulloren e institucionit me qëllim që të ketë përfitime personale ose përfitime të tjera, do të dënohet me deri dy vjet burg.

Neni 79. Ekzekutimi i dënimeve me burgim dhe masat e sigurisë

Me kërkesë të të dënuarit, masa sigurisë për çdo vepër penale të kryer nga punonjësit e forcave të policisë sipas nenit 16, është e parashikuar tek kodi penal ushtarak.

Dispozita e paragrafit të mësipërm zbatohet edhe në rastet kur subjektet janë vendosur në paraburgim ose burgim parandalues. Në këto raste kërkesa mund t'i drejtohet zyrtarëve ose agjentëve të policisë gjyqësore ose forcave publike në procesverbal referuar nenit 266 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 80. Gjykimi drejtëpërdrejtë

Për veprat penale të parashikuara në nenet 72, 73, 74, 75, 76 dhe 77 të ligjit në fjalë, procedohet në çdo rast me gjykim të drejtëpërdrejtë, përveç rasteve kur është e nevojshme të masa hetimore.

Për veprat penale të lidhura procedohet me ndarje gjykimesh.

KAP VII – Normat e qëndrimeve politike. Përfaqësimi i të drejtave sindikaliste

Neni 81. Normat e sjelljes politike

Punonjësit e forcave të policisë duhet që në çdo rast të mos përfshihen në konkurse politike dhe nuk mund të mbajnë qëndrime që komprometojnë paanshmërinë absolute të funksioneve të tyre. Punonjësve të policisë ju ndalohet të marrin pjesë me uniformë, edhe pse jashtë shërbimit, në grumbullime, manifestime, organizime politike ose sindikaliste, përveç rasteve të parashikuara në nenin e mëposhtëm. Po ashtu, është e ndaluar të kryhet propagandë në favor të partive politike, shoqatave dhe organizatave politike ose kandidatët në zgjedhje.

Punonjësit e forcave të policisë në zgjedhjet politike ose administrative janë vende që marrin leje të papaguar që nga momenti që ju pranohet kandidatura dhe për gjatë gjithë kohëzgjatjes së fushatës elektorale që do të kryejnë aktivitet dhe propagandë politike, jashtë zyrave të punës dhe të veshur civil. Gjithashtu, nuk mund të kryejnë më shërbim në qarkun ku janë kanë kandiduar për zgjedhje për një periudhë

trevjeçare.

Neni 82. Të drejtat sindikaliste

Punonjësit e Policisë së Shtetit kanë të drejtë të anëtarësohen në sindikatë.

Por, nuk mund të anëtarësohen në organizata të ndryshme nga ato që përfaqësojnë policinë dhe as të kërkojnë përfaqësim për punë të tjera.

Punonjësit e policisë së shtetit, jashtë orarit të shërbimit, mund të shkojnë në mbledhje të veshur me uniformë:

a) Në ambiente që i përkasin administratës, që janë vënë në dispozicion nga vetë ajo dhe që përcakton mënyrën e përdorimit;

b) në vende të hapura për publikun.

Mund të mbahen mbledhje gjatë orarit të punës deri në dhjetë vjet në vit. Drejtuesit e Policisë së Shtetit kanë detyrën të caktojnë kohën dhe vendin për kryerjen e takimeve.

Neni 83. Sindakata e Policisë së Shtetit

Sindikata e personelit të policisë së shtetit formohet, drejtohen dhe përfaqësohen nga punonjës së policisë së shtetit, në shërbim, por megjithatë në shërbim të kufizuar dhe që mbrojnë interesat, pa ndërhyrë në drejtimin ose detyrat operacionale.

Por, nuk të aderojnë, përfshihen ose të kenë marrëdhënie të karakterit organizativ me shoqata të tjera sindikaliste.

Neni 84. Ndalimi ushtrimi të së drejtës për grevë

Punonjësit e policisë së shtetit nuk kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën për grevë dhe as veprime të ngjashme të cilat gjatë shërbimit mund të kompromentojnë rendin dhe sigurinë publike ose aktivitetet e policisë gjyqësore.

Neni 85. Këshilli kombëtar i policisë

Është instituti kombëtar i këshillit të policisë dhe organ i Ministrisë së Brendshme për çështjet e mëposhtme që lidhen me administratën e sigurisë publike:

a) nisma ligjore të Ministrit të Brendshëm, rregullore dhe masa administrative të një karakteri të përgjithshëm dhe për pjesët që lidhen me anën ligjore dhe sigurimet shoqërore të stafit;

b) urdhëresa dhe programe të institucioneve të formimit profesional dhe kriteret për zhvillimin e konkursit;

c) çdo çështje tjetër që Ministri dëshiron të ngrejë tek këshilli kombëtar.

Opinionet, e nenit të mësipërm, duhet të shprehen brenda tridhjetë ditësh nga kërkesa, pas së cilës Ministri ka detyrën të parashikoj.

Në raste më urgjente, Ministri mund të caktojë një afat më të shkurtër gjatë së cilës duhen shprehur mendimet, ose njofton këshillin kombëtar.

Rregullorja e Këshillit Kombëtar është e miratuar nga Ministri, me propozim të vetë këshillit, brenda tre muajsh nga paraqitja në fjalë.

Për vlefshmërinë e anëtarëve është e nevojshme prania e të paktën dy të tretave të komponentëve në thirrjen e parë dhe gjysmës në thirrjen e dytë.

Neni 86. Përbërja e këshillit kombëtar të policisë

Këshilli kombëtar i policisë kryesohet nga Ministri Brendshëm ose nga një sekretar i deleguar prej tij.

Pra, është i përbërë nga gjashtëdhjetë anëtarë, nga të cilët:

a) tridhjetë të caktuar nga Ministria e Brendshme, nga të cilët njëzet të zgjedhur nga strukturat e ndryshme të administratës së sigurisë publike, të cilët plotësojnë kriteret për përfaqësim, ata që mbesin zgjidhen nga pjesa civile e administratës së brendshme, nga pjesa tjetër e administratës së shtetit, përfaqësues të shoqatave të sigurisë publike që kanë dalë në pension dhe nga të huajt në administratën shtetërore të cilët janë ekspert të fushave përkatëse të këshillit kombëtar;

b) tridhjetë zgjidhen sipas kriterëve të nenit vijues.

Këshilli kombëtar është i vlefshëm për tre vjet.

Anëtarët e tij nuk zgjidhen më automatikisht pas dy mandatesh konsektive.

Neni 87. Zgjedhja e delegatëve për komponentët e policisë

Për të proceduar me zgjedhjet sipas nenit të mësipërm, punonjësit e Policisë së shtetit janë ndarë në fazat e mëposhtme elektorale:

a) grupi që përfshin agjentët;

b) grupi që përfshin asistentët, superintendentët dhe inspektorët;

c) grupi që përfshin drejtuesit dhe komisarët.

Zgjedhjet e komponentëve të Këshillit kombëtar bëhen me dorëzimin e një liste kombëtare e cila përfshin më shumë kandidat sa herë që parashikohet nga Ministri Brendshëm në proporcion me numrin e punonjësve në organikë.

Çdo listë duhet të nënshkruhet nga jo më pak se 500 dhe jo më shumë se 1.000 zgjedhës,

pjesëmarrës të çdo faze.

Asnjë zgjedhës nuk mund të nënshkruajë më shumë se një listë.

Çdo zgjedhës merr një fletë votimi në grupin e tij përkatës dhe shkruan listën me votat e preferuara: dy nëse kandidatët që do të zgjidhen janë deri në 7, katër nëse kandidatët që do të zgjidhen janë deri në 18.

Shifra elektorale e secilës listë përbëhet nga shuma e votave të vlefshme të dhëna në secilën grup.

Shpërndarja e posteve sipas listës bëhet me metodën normale, kush ka më shumë vota mbetet.

Vendet e caktuara sipas secilës listë ndahen midis grupeve të ndryshme sipas procedurës së mëposhtme:

a) numri total i votave të marra nga secila listë në grupin e parë ndahet sipas numrit të votave të vlefshme nga çdo grup dhe numrin total të kandidatëve të parashikuar në paragrafin e dytë për të njëjtin grup;

b) veprimet e parashikuara në pikën e mësipërme ndiqen edhe për grupet e tjera;

c) për të arritur rezultatet përdoret metoda d'Hondt.

Në fund për shpalljen e kandidatëve ndiqet rendi i përcaktuar sipas secilit grup, në bazë të votave që ka marrë secili kandidat. Sipas votave zgjidhet kandidati që kryeson rendin në listë.

Data për zgjedhjen e komponentëve të Këshillit kombëtar përcaktohet me dekret të Ministrisë të Brendshme jo më vonë se dita e dyzet e pestë para përfundimit të mandatit trevjeçar të Këshillit ekzistues.

Zgjedhjet duhet të mbahen jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas përfundimit të këshillit kombëtar sipas paragrafit të mësipërm.

Modalitetet dhe kushtet për mbajtjen e zgjedhjeve që nuk janë parashikuar në këtë nen, përcaktohen me dekret të Presidentit të Republikës, pasi shqyrtohet nga këshilli ministrave, me propozim të Ministrisë të Brendshme, dhe duhet të nxirren brenda një muaji nga hyrja në fuqi e dekretit për delegatët sipas nenit 36.

Për zgjedhjen e parë të Këshillit, që mbahet brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit aktual, grupet elektorale përbëhen përkatësisht:

1) nga roje dhe të caktuar;

2) nga zv.brigadier, brigadier, marshall dhe asistente policie femra;

3) nga komisarë, zyrtarë, inspektorë dhe drejtues.

Do mbahen zgjedhje të reja të këshillit brenda gjashtë muajsh nga futja në fuqi e dekretit sipas nenit 109.

Neni 88. Leja e papaguar për arsye sindikaliste

Punonjësit e policisë së shtetit që mbajnë pozicione drejtuese në organizatat e tyre sindikaliste të mëdha me karakter kombëtar përfaqësunu, duhet që të paraqesin kërkesë për leje të papaguar për motive sindikaliste nëpërmjet organizatës përkatëse. Numri global i punonjësve që mund të marrin leje të papaguar është caktuar 2.000 punonjës së organikës.

Shpërndarja midis organizatave të ndryshme sindikaliste, përfaqësimi për çështje të tjera për të njëjtën ndarje territoriale, parashikon bëhet brenda tremujorit të parë të çdo trevjeçari pasi Ministri Brendshëm dëgjon organizatat e interesuara.

Transferimet në vende të tjera për punonjësit e policisë së shtetit që mbulojnë detyra sindikaliste mund të bëhet të efektshme pasi dëgjohej organizata sindikaliste në fjalë.

Transferimet në një zyrë që nuk i përket policisë së shtetit, po që është komponent i sekretarisë kombëtare, sekretarive rajonale dhe provinciale të sindikatave me karakter kombëtar më përfaqësi të madhe, mund të bëhen të efektshme pasi miratohen nga anëtarët e sindikatës.

Neni 89. Trajtimi ekonomik i personelit me leje të papaguar për motive sindikaliste

Personeli që merr leje të papaguar sipas nenit të mëparshëm, do të vazhdojë të trajtohet si pjesë e administratës, të gjitha pagesat do të bëhen sipas dispozitave ekzistuese, sipas kategorisë së lejes, me përjashtim të asaj kategorie pagesash që trajtojnë financiarisht orët shtesë ose shërbimet apo funksionet që lidhen me një natyrë të veçantë sipas performancës së punës. Nga pagesat e mësipërme zbriten, sipas deklaratës që lëshohet nga i interesuari, ato pagesa që mund t'i takojnë sindikatës si paga, dhe përjashtimi trajtimet financiar për rimbursim të shpenzimeve. Periudha e lejes së papaguar për motive sindikaliste është e dobishme në çdo aspekt, përveç lejes së periudhës së provës dhe të drejtës për leje vjetore. Periudha provës përfundon me përfundimin për cdo arsye të mandatit sindikaliste.

Neni 90. Mungesat nga zyra për motive sindikaliste

Punonjësit e policisë së shtetit sipas nenit 88, që janë pjesë përbërëse e organeve kolegjiale staturore të organizatave sindikaliste por që nuk janë me leje të papaguar për sindikatën, me kërkesë të organizatës përkatëse, janë të autorizuar, përveç rasteve të përjashtuara kur po kryejnë shërbim, të marrin leje nga zyra për kohën e nevojshme për të marrë pjesë në takimet e organit kolegjial ose për të marrë pjesë në aktivitetet normale sindikaliste. Për secilën provincë dhe çdo organizatë sindikaliste jepet autorizim për tre punonjës dhe për një periudhë që nuk i kalon tre ditë në muaj. Në këtë mënyrë nuk llogariten mungesat nga puna rastet e pjesëmarrjes në kongrese ose konferenca kombëtare për qëllime sindikaliste në mbrojtje të administratës. Për raste të veçanta në organizatë, administrata mund të autorizojë ditë leje shtesë që kalojnë kufirin e parashikuar.

Neni 91. Trajtimi ekonomik i përfaqësuesve që marrin leje të papaguar për motive sindikaliste nga shërbimi

Personeli i parashikuar në nenin e mësipërm, veç trajtimit të zakonshëm, ka të drejtë

edhe për pagesat dhe shpërblimet për kryerjen e shërbimit apo funksioneve me një karakter të veçantë.

Periudhat e lejes së autorizuar, kombinohen me lejen vjetore dhe orët shtesë dhe janë të vlefshme në të gjitha aspektet, juridik dhe ekonomik.

Neni 92. Disponueshmëria e hapësirave në mur dhe ambienteve për aktivitetet sindikaliste

Tek zyrat qendore dhe vendore të Policisë së Shtetit ju jepet mundësia shumë organizatave sindikaliste të përdorin falas hapësirat për të vendosur në mur njoftime, qarkore, postera dhe njoftime të tjera me shkrim sipas dispozitave të përgjithshme ku përcaktohet që këto njoftime duhet të jenë ekskluzivisht për sindikatën, dhe në vende të ndryshme nga ato që përdoren për publikun.

Secila prej organizatave sindikaliste me karakter kombëtar dhe me përfaqësi të madhe, ndër të tjera, ju jepet për përdorim falas ambient që mund të shërbej si zyrë për sindikatën, gjithmone duke pasur parasysh rregullat e përcaktuara nga administrata, pasi merret dhe mendimi i organizatave sindikaliste.

Neni 93. Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve sindikaliste

Punonjësit e policisë së shtetit që kanë detyrë të paguajnë tarifën e regjistrimit për të qenë anëtar të sindikatës, e cila mund të merret nga paga ose trajtimet e tjera financiare, e cila do të shërbejë për të paguar kontributet sindikaliste shuma e të cilave përcaktohet nga organet kompetente staturore. Mbetet e pandryshueshme dispozita e nenit 70 për testin unik që miratohet me dekret të Presidentit të Republikës më 5 Janar 1950, nr.180.

Shuma është e vlefshme nga dita e parë e muajit pas 31 Dhjetorit të çdo viti dhe do të rinovohet automatikisht nëse nuk kërkon të kundërtën e interesuari brenda 31 Tetorit. Kërkesa për anulim do të bëhet me shkrim drejtuar sindikatës dhe administratës. Zbritjet që do të bëjnë administrata nga rroga për këtë qëllim do të bëhen sipas procedurave të përcaktuara më parë.

Neni 94. Përdorimi i personelit me aftësi të kufizuara nga shërbimi

Mbetet e pandryshueshme dispozita me pikën XX) e nenit 36, Qeverisa e Republikës së Italisë është e detyruar të lëshojë, brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit aktuale, një dekret që detyron parashikojë në organikë të administratës për punonjësit e policisë që kanë pësuar dëmtime për shkak të punës dhe që nuk mund të ofrojnë shërbim të plotë për shkak të aftësive të kufizuara

leksione ose detyra të tjera të institucionet, sipas kriterëve të mëposhtme:

- 1) personeli në fjalë duhet të ketë detyra të reduktuara sipas rekomandimeve të dhëna nga vetë mjeku që kanë përcaktuar paaftësinë; personeli mësipërm mund të përfitojë asistencë ose të përdoret Fondi ndihmës për personelin e sigurisë publike;
- 2) personeli mësipërm vazhdon të zbatojë normat e parashikuara nga shtetit për karrieren ;
- 3) të njëjtit personel i garantohet trajtimin ekonomik sipas karrieres së punonjësve, si dhe pagesën e një granti sipas shkallës së paftësisë e cila mund të kombinohet me forma të tjera asistence;
- 4) do të parashikohen modalitete të tjera specifike për transferimin e personelit të mësipërm në rast se ka nevojë për asistencë shëndetësore.

Neni 95 Marrëveshjet sindikaliste

Marrëveshjet sindikaliste parashikuar nga ligji në fjalë parashikohen nga delegacioni përbërë nga Ministri i funksionit publike, Ministri brendshëm, Ministri Thesarit dhe

sekretarët e përgjithshëm, në këtë delegacion do të bëjnë pjesë edhe përfaqëues së sindikatave me përfaqësi të madhe në shkallë kombëtare.

Mbetet e njëjtë dispozita e nenit 43, në marrëveshje edhe me sindikatat për orët e punës, sipas nenit 63, pushimet kombëtare, lejet, pritshëritë, pagesa e orëve shtesë, kriteret për trajnim dhe rritje profesionale.

Nëse marrëveshjet e paragrafit të mësipërm, për trajtimin ekonomik nuk arrihen brenda afatit të caktuar, Ministri Brendshëm i referohet Dhomës së Deputetëve dhe senatit të Republikës për normat dhe zbatimin e rregulloreve përkatëse.

KAP VIM – normat tranzitore dhe përfundimtare

Neni 96. Disiplina provizore e personelit

Deri në hyrjen në fuqi të urdhrin për personelin e administratës së sigurisë publike, statusi ligjor paradhëniet, trajtimet financiare dhe pensionet administrohen për personelin që bën pjesë në administratën e sigurisë publike, duke pasur parasysh rolin organik të funksionarëve të policisë së shtetit. Roli i inspektorëve të policisë dhe roli asistentëve të policisë përcaktohen përkatësisht në policinë e shtetit. rolet organikë të zyrtarëve, nënzyrtarëve, rojeve të zgjedhura nga forcat e sigurisë publike emërohen në rolin organik të zyrtarëve, nënzyrtarëve, roje Policisë së Shtetit.

Roli i i punonjësve të magazinavë dhe efektivit të rojeve si dhe punonjësve të përhershëm në shkollat e policisë emërohen përkatësisht, në vendet organike të punonjësve si dhe administratën e shkollës së sigurisë publike;

b) Roli i oficerëve mjekësor në personelin e policisë së sigurisë publike do të emërohet si roli organik për shëndetin në Policinë e Policisë së Shtetit;

c) punonjësit e policisë së shtetit në rolin organik të funksionarëve, inspektorëve, zyrtarëve, asistentëve, rojeve të Policisë së Shtetit janë zyrtarë dhe agjentë të sigurisë publike të policisë gjyqësore sipas rregulloreve aktuale në fuqi për punonjësit e Forcave të sigurisë publike si dhe për punonjësit e administratës së sigurisë publike;

d) mjekët në rolin organik të sanitarëve të policisë së shtetit, janë zyrtarë të sigurisë publike dhe të policisë gjyqësore dhe kanë atributet që ju jep ligji në fuqi;

e) Punonjësit në rolin organik të inspektorëve, ushtrojnë funksione dhe detyra të parashikuara në organikë për funksionarët e administratës së sigurisë publike;

f) punonjësit në rolin organik të funksionarëve dhe inspektorëve, vec attributeve dhe detyrave të përcaktuara nga rregulloret në fuqi për funksionarët e sigurisë publike, mund të ushtrojnë sipas kualifikimeve që kanë, edhe attribute të tjera të parashikuara për efektivin e sigurisë publike;

g) punonjësit e policisë në rolin organik të të zyrtarëve, vec attributeve të caktuara prej ligjit në fuqi për zyrtarët, mund të ushtrojnë në varësi të gradës që kanë edhe attribute dhe detyra të tjera të parashikuara për punonjësit në rolin organik për funksionarët e administratës së sigurisë publike;

h) në përfundim të zbatimit të dispozitave të pikave f) dhe g) të nënit aktuale, me dekret të Ministrit të Brendshëm përcaktohet kriteret për pikën m) për funksionet koresponduese sipas kualifikimit dhe gradave për punonjësit që kanë rol funksionarësh në organikë, të zyrtarëve dhe inspektorëve. Funksionet dhe përgjegjësitë të eprorëve hierarkik përta i përket disiplinës, punësimit dhe trajnimit e personelit në varësi të kuesturës dhe zyrave në varësi janë përgatitur për funksionarët e policisë për drejtimin e vetë këtyre zyrave.

Funksionet dhe përgjegjësitë analoge janë për funksionarët e policisë që drejtojnë komisariatet e sigurisë publike, përfshi kompartmentet e hekurudhave shtetërore,

postave të telekomunikacionit në drejtim të pikave kufitare tokësore dhe ajrore;

i) për punonjësit në rolin organik të zyrtarëve, inspektorëve, asistentëve, të emeruarve, rojeve të zgjedhura zbatohet trajtimi ekonomik për orët shtesë sipas masave të parashikuara për funksionet civile të administratës së sigurisë publike;

l) funksionarët e administratës së sigurisë publike si dhe inspektorët femra të policisë zbatojnë trajtimin ekonomik parashikuar për nënpunësit e rojeve të sigurisë publike, përveç rasteve të trajtimit ekonomik preferencial të parashikuar më sipër. Për punonjësit me kualifikimet drejtuese ndryshimi në trajtimin ekonomik varion sipas titullit të punonjësit;

m) përsa i përket lidhjes midis kualifikimit të funksionarëve dhe gradave të zyrtarëve, i referohet neni 143 të ligjit të 11 Korrikut 1980, n. 312;

n) dispozitat e nenit 7, të ligjit të 10 Tetorit 1974 nr. 496, për punonjësit e policisë së sigurisë publike zbatohet dekreti ligjor i 21 Gushtit 1945, n. 601. Për nënpunësit që vijnë nga forcat ish luftarake ose partizanë, në shërbim që prej 1 Janarit 1971, që nuk u prekën në ndryshimi karrierës sipas nenit 7 dhe 8 të 10 tetorit 1974 n. 496, nuk zbatohen dispozitat e neneve 5, paragrafi fundit dhe 9 i të njëjtit ligj;

o) personeli që prej 31 Dhjetori 1972 ka marrë cilësinë e kryekomisarit të sigurisë publike ose kryeinspektores për policinë e femrave dhe që hyn në fuqi me ligjin e 11 Korrikut 1980 n. 312, nuk do të mbaj më titullin e zëvendës shefit ose inspektorit apo zëvendësit sipas nenit 155, paragrafi fundit, Akti i 11 Korrikut 1980, nr. 312 ;

p) drejtuesit e sigurisë publike, nëse brenda gjashtëdhjetë ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij Akti, nuk bëjnë kërkesë për kalimin në rolet e reja sipas pikës X), numri 27, i nenit 36, rreshterët e përgjithshëm të forcave të sigurisë publike do të përfshihen në kategorinë e prefektëve të përgjithshëm drejtues, por do të ruajnë vjetërsinë e gradës dhe kualifikimin, deri në tre muaj pas hyrjes në fuqi të të njëjtit ligj, duke pasur parasysh nevojën për të përgatitur Strukturat drejtuese për zbatimin e ligjit dhe për organizimin e administratës së sigurisë publike.

Gradat caktohen me urdhër të Ministrit të Brendshëm, pasi dëgjohen palët e interesuara, deri në 11 poste nga të cilët sipas paragrafit të parë të nenit 42, zbriten nga ky kontigjent 1 post i cili përcaktohet në paragrafin e fundit të njëjtit nen ;

q) për mbulimin posteve që mbeten të lirë në kontigjent sipas paragrafit të parë të nenit 42, pas dispozitave dhe kuadrit të cilit i referohet nënparagrafi mësipërm dhe për përcaktimin e ditëve pushim, parashikohet sipas emërimit të drejtuesve të tjerë të përgjithshëm prefekt, niveli C, të zgjedhur midis drejtuesve të sigurisë publike dhe majorëve në trupat e rojeve të sigurisë publike të cilët nuk kanë aplikuar për të ndërruar gradë në rolin e tyre nëntëdhjetë ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Gjatë zbatimit të ligjit në fjalë është rezervuar një vend për majorët e përgjithshëm të trupave të gardës të sigurisë publike

r) gjatë zbatimit të mëparshëm të ligjit në fjalë, zëvendës shefi policisë që ushtron funksione zv.drejtuesit dhe inspektorit të gardës së sigurisë publike gjatë kohës që hyri në fuqi ligji dhe që kanë të paktën katër vjet vjerësi pune ose gradën, klasifikohen në kategorinë e prefektëve të klasës së parë;

s) në komisione sipas nenit 8 të Ligjit 1965 nr. 1366, inspektorët e përgjithshëm Lieutenant të trupave të gardës të shkrirë të rendit publik dhe zëvendësohet nga personeli qendror në departamentin e sigurisë publike.

Neni 97. Tabela organike e drejtuesve

Në kuadrin A të tabelës III dekreti Presidentit të Republikës 10 Qershor 1972

n. 748, fjalët: «Shefi i policisë dhe drejtues», «Shefi policisë dhe prefekt» dhe «Shefi policisë» zëvendësohen përkatësisht: «shefi policisë – drejtor i përgjithshëm i sigurisë publike dhe drejtues» «Shefi policisë- drejtor i përgjithshëm i sigurisë publike dhe prefekt, «Shefi policisë – Drejtor i përgjithshëm i sigurisë publike».

Vendet tenent të përgjithshëm i gardës së sigurisë publike sipas tabelës së parashikuar në nenin 3 të ligjit të 10 Dhjetorit 1973 1973, n. 804, eliminohen.

Vendet drejtues i përgjithshëm i sigurisë publike sipas segmentit C ta tabelës III të Dekretit të Presidentit të Republikës më 30 Qershor 1972 nr.748, janë shtuar, sëbashku me me postet në paragrafin e mësipërm për kategorinë e drejtuesit të përgjithshëm, niveli funksional C, administratës civile, sipas segmentit A të tabelës III.

Drejtuesit e përgjithshëm të sigurisë publike dhe tenenti të gardës së sigurisë publike janë parashikuar për rolin e drejtuesit të përgjithshëm të pjesës civile të administratës sipas kriterëve të parashikuara në nenin e mëparshëm.

Neni 98. Bandat muzikore

Qeveria duhet të lëshojë, brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi të ligjit, një dekret me fuqi ligjore për të aktivizuar bandën muzikore të gardës së sigurisë publike sipas strukturës së re të Policisë së Shtetit, duke përzgjedhur stafin e duhur që kanë vlerat artistike për të qenë pjesë e bandës.

Neni 99. Raporte dhe të dhëna. Dispozita tranzitore

Deri në futjen në fuqi të urdhrin të ri për personelin e administratës së sigurisë publike,

siç kërkohet, diktohen me dekret Ministri të Brendshëm dhe pasi dëgjohen sindikatat e policisë, më shumë përfaqësues në rang kombëtar, normat për hartimin e raporteve informative, vlerësimin e përgjithshëm, rishikimin e gjykimeve sipas bazës ekzistuese ligjore.

Neni 100. Administrimi dhe kontabiliteti

Që me fillimin e normave së administratës dhe kontabilitetit të administratës së sigurisë publike mbeten operacionale normat e kontabilitetit që parashikuar për gardën e sigurisë publike si dhe masat e përgjithshme të kontabilitetit që zbatohen për vetë efektivin.

Parashikimet e bilancit parashikuar për pjesën financiare për gardën e sigurisë publike dhe administratës së sigurisë publike janë caktuar për shpenzimet e administratës së sigurisë publike. Shpenzimet për pastrimin e kazermave në përdorim të ministrisë së brendshme për Policinë e Shtetit dhe Efektivin e Karabinierëve, do t'i ngarkohen zërit të shpenzimeve të ministrisë së brendshme.

Neni 101. Martesa për punonjësit e administratës së sigurisë publike

Normat që disjplinojnë personelin e administratës së sigurisë publike detyrimin për t'u martuar do të shfuqizohen.

Neni 102. Konkursi publik për inspektorët

Për mbulimin e vendeve të lira për rolin e inspektorëve ku nuk parashikohen më shumë se 500 poste, Ministri i Brendshëm është i autorizuar të shpall, brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit aktual, konkursin publik që përcakton numrin e vendeve për secilin rajon dhe për secilën provincë.

Në konkurs mund të marrin pjesë nënshtetasit italian që plotësojnë kërkesat e nenit

52.

Afati për përfundimin e aplikimeve për konkursin është 30 ditë nga publikimi i njoftimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Italisë dhe provimi do të fillojë brenda 60 ditëve në vijim.

Konkursi është një provim me temat e mëposhtme:

e drejta penale, e drejta e procedurës penale, kushtetuta, e drejta administrative; legjislacioni specail administrativ për lëndët e sigurisë publike.

Sic parashikohet në nenin 59, Ministri i Brendshëm vendos, me dekretin e tij, për konkursin në paragrafin e mësipërm, për komisionin që do të bëjë vlerësimin, në përputhje me numrin e konkurrentëve si dhe përbërjen e komisioneve për qarqet si dhe kriteret e pranimit së kushteve fizike dhe psikologjike për vlerësimin e cilësisë.

Fituesit e konkursit caktohen inspektorë dhe shkojnë si studentë për një periudhë gjashtëmujore, ku marrin njohuritë teknike dhe profesionale për zbatimin e ligjit dhe oficerët e policisë gjyqësore, sidomos në lidhje me veprimtaritë hetuese, sipas programit që është caktuar nga Ministri Brendshëm.

Studentët do të përfundojnë trajnimin duke marrë pjesë një një kurs tremujor trajnimi në Shkollën e Policisë sipas programit përcaktuar me dekret të Ministrit të Brendshëm.

Kandidatët duhet të specifikojnë gjatë pjesëmarrjes në konkurs preferencën e tyre se ku duan të shërbejnë pasi të përfundojnë trajnimin.

Emërimet në secilin qark do të përcaktohen sipas rezultateve në provim duke pasur parasysh preferencat për fushën e shërbimit që ka shprehur vetë kandidati sic parashikohet në paragrafin e mësipërm.

Fituesit e konkursit mund të transferohen nga zona ku janë emëruar, ose të komandohen për të kryer shërbim diku tjetër, vetëm katër vjet pas fillimit të karrierës.

Në rastet se nuk ka ndryshime, zbatohen dispozitat e këtij ligji për personelin me rol inspektori.

Neni 103. Personali administrativ

Për detyra administrative të Administratës së Sigurisë Publike, sipas parashikimit në nenit 40, postet organike për administratën civile janë rritur me 1.200 poste për punonjësit e karrierës ekzekutive në rol zyre, 1.100 vende tek arkivi, 650 poste karriere të konceptit administrativ dhe 50 poste për karrierën drejtuese administrative dhe një total prej tremijë vendesh.

Për plotësimin e vendeve të mësipërme bosh do të ndiqen kriteret e mëposhtme: për plotësimin e vendeve administrative dhe menaxheriale do të përdoret lista me kandidatët e suksesshëm në konkurset publike që janë bërë në 1979, 1980 dhe më hyrjen në fuqi të këtij ligji për akses në postet e sipërpërmendura; për mbulimin e posteve të karrierës ekzekutive në zyra dhe në rolin e arkivit do të përdoren deri në 50% të vendeve të disponueshme dhe të përshtatshme sipas konkurseve që janë bërë në 1979 dhe 1980 ose me hyrjen në fuqi të këtij ligji për të drejtën për karrierë.

Për plotësimin e vendeve të mbetura që nuk mbulohen nga kjo listë, Ministria e Brendshme është e autorizuar të shpallë konkurse publike të cilët duhet të zhvillohen sipas kushteve të nenit

102 dhe të përcaktohet kushtet për pranimin në provim sipas rregulloreve në fuqi.

Për mbulimin deri në 30% të vendeve sipas nenit 40, Ministri i Brendshëm është i autorizuar të shpallë konkurse publike sipas kushteve të Nenit 102 dhe të caktojë kriteret e provimit sipas legjislacionit në fuqi.

Përbërja organike për rolin e agjentëve, asistentëve dhe superintendëtëve reduktohet me 2,500 për të mbuluar shpenzimet e sipërpërmendura.

Neni 104. Normat tranzitore për çështjet e juridiksionit

Për çështjet në ngarkim të personelit të gardës së sigurisë publike në gjykatat ushtarake, i transferohen autoriteteve kompetente gjyqësore në territor që mbulon këto çështje. Proceset që mbeten pezull në gjykatën e lartë ushtarake i transferohen gjykatës së apelit ose gjykatës së apelit në territorin kompetent.

Neni 105. Amnestia disiplinore

Sanksionet disiplinore që zbatohen për funksionarët e sigurisë publike, punonjësve të gardës së sigurisë publike dhe forcave të femrave për çështje që kanë të bëjnë për mbrojtjen e interesave kryhet nga sindikatat me vendim të Ministrit të Brendshëm. Përfshihen rastet që lidhen me ndjekjet penale.

Neni 106. Organika e roleve drejtuese

Deri në momentin që do të jenë stabilizuar vendet e reja organike me rol drejtues, sipas nenit 97, organika aktuale e adminstrata do të ketë nëpunës të sigurisë publike, oficerë të trupave të gardës dhe inspektore femra të policisë.

Neni 107. Kalimi në vende të tjera civile të administratës ose trupave ushtarakë të shtetit Stato

Qeveria e Republikës duhet që brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e Ligjit, të lëshojë një ose dy dekrete që kanë forcën e ligjit për kalimin e punonjësve të administratës së sigurisë publike dhe administratës tjetër të shtetit si dhe anëtarëve aktual të gardës së sigurisë publike tek forcat ushtarake të shtetit sipas kriterëve:

1) të lejojë punonjësit e administratës së sigurisë publike, që vijnë nga role nëpunësve të sigurisë publike dhe nga pjesa e femrave në polici, duke ruajtur pozicionet juridike dhe ekonomike, kalimi nga administratën civile apo struktura të tjera të administratës publike, duke ruajtur të njëjtat të drejta dhe pozicionet e personelit punonjës të administratës;

2) të lejojë punonjësit e administratës të sigurisë publike që vijnë nga vendet e shkëputura të të gardës së sigurisë publike, përfshirë zyrtarë në pozicione pritjeje dhe rezervë, që mbeten në të njëjtat pozicione dhe gjatë kalimit në forcat e tjera të policisë ruajnë të njëjtat pozicione juridike dhe ekonomike, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Ministri i interesuar, dhe duke ruajtur në çdo rast të drejtat dhe në vendin ku do të kalojnë në administratë. Për zyrtarët në pozicione ndihmëse dhe rezervë kalimi miratohet për të njëjtin pozicione edhe në ushtri dhe trupat e tjerë;

3) mundësinë, për ata që duhet të zbatojnë pikat e mësipërme që të bëhen të efektshme brenda tre muajsh nga nxjerrja e dekretit sipas nenit 36 dhe 40 të të njëjtit ligj.

Neni 108. Përfundimi parakohshëm i shërbimit

Qeveria e Republikës është e detyruar që të parashikoj brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, një dekret që ka forcë ligjore, për rastet e përfundimit të parakohshëm të shërbimit për disa nga funksionet të administratës të sigurisë publike si dhe për punonjësit e gardës së sigurisë publike sipas kriterëve vijues;

b) t'i mundësojë kolonolët-togerët e trupit të gardës së sigurisë publike dhe zëvendës kuestorëve të administratës së sigurisë publike të kenë të drejtën të kërkojnë përfundimin e parakohshëm të shërbimit në moshën pesëdhjetë e pesë vjeçare;

c) t'i mundësojë inspektorëve dhe asistentëve të pjesës së femrave në polici, të cilat kanë mbushur moshën dyzet e trevjeçare të kërkojnë përfundimin e parakohshëm të shërbimit;

d) të lejojë zv.rreshterët, rreshterët, marashallët e trupave të sigurisë publike, të cilët kanë mbushur përkatësisht moshën pesëdhjetë e katër, pesëdhjetë e gjashtë, pesëdhjetë e tetë, të kërkojnë përfundimin e parakohshëm të shërbimit.

Përfundimi parakohshëm i shërbimit sjell rritje në gradë dhe kualifikim

më të lartë që ka efekt që nga momenti që lihet shërbimi si dhe ka përfitime në fusha të tjera sipas nenit 6, paragrafi parë, i ligjit të 3 Nëntorit 1963, n. 1543.

Në rastin që nuk do të ketë gradë më apo kualifikim më të lartë do ti jepen tre shkallë vjetërsi më shumë automatikisht.

Atributet e benefiteve nga paragrafet e mësipërm nuk janë të kombinuar me benefite të tjera përveç rasteve kur bëhet fjalë për pensionin.

Neni 109. Lëshimi dekreteve

Normat e nxjerrë me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të Kreut të Këshillit të Ministrave, në akord me Ministrin e Brendshëm dhe Ministrin e Thesarit, duke marrë mendim nga komisionet kompetente të Dhomës së Deputetëve dhe Senatit të Republikës.

Mendimi i komisionit nuk do të merret parasysh nëse nuk shprehet brenda gjashtëdhjetë ditësh nga kërkesa. Kur mendimi merret brenda gjashtëdhjetë ditësh, skema dekretit i dërgohet këshillit të ministrave për mendim paraprak dhe pastaj Dhomës për të marrë mendim nga komisionet kompetente të përkohshme, i cili duhet të shprehet brenda tridhjetë ditësh nga momenti që është bërë kërkesa e Qeverisë.

Pasi merret mendimi brenda tridhjetë ditësh, rregullat aprovohen në përfundim nga Këshilli i Ministrave.

Neni 110. Ndryshimi emërtimeve

Ndryshimi emërtimit Garda e sigurisë publike dhe trupat e policisë femërore sipas ligjit të mëparshëm, do të zëvendësohen nga emërtimi Policia e Shtetit.

Neni 111. Rregulloret për administratën e sigurisë publike dhe trupat e shkrirë të gardës së sigurisë publike

Rregulloret për shërbimin e administratës së sigurisë publike nxirren me dekret të Presidentit të Republikës, nëpërmjet këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrin të Brendshëm, pasi dëgjohen sindikatat e policisë që kanë përfaqësim në nivel kombëtar.

Në periudhën e ndërmjetme nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe shfuqizimit të ligjit të mëparshëm, për të cilin zbatohet paragrafi mësipërm, për ato çështje që nuk parashikohen në nga ligji aktual dhe nëse janë në pajtueshmëri me të do të zbatohen dispozitat e rregullores së nxjerrë me Dekret Mbretëror më 30 nëntor 1930 n. 1629, dhe modifikimet përkatëse.

Në këto dispozita emërtimi Trupat e Gardës së Sigurisë Publike zëvendësohet më Administrata e Sigurisë Publike.

Neni 112. Trajtimi me pension në fazën tranzitore

Personeli që përfundon shërbimin me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe para futjes në fuqi të urdhrit sipas nenit 36, përfiton pension dhe trajtim financiar njësoj me ato që përfitojnë efektivet në shërbim dhe me të njëjtat kualifikime.

Personeli i Trupave të Gardës së Sigurisë Publike që deri në futjen në fuqi të këtij ligji, është në pozicione ndihmëse dhe rezervë përfiton të njëjtin trajtim financiar si karabinerët në pozicione analoge.

Neni 113. Raportmi Ministrisë të brendshme

Ministri brendshëm raporton çdo vit parlamentit me relacion mbi veprimtaritë e forcave të policisë së shtetit për rendin dhe sigurinë publike në rang kombëtar.

Neni 114. Ndalimi i pjesëmarrjes në parti politike

Deri në hyrjen në fuqi e një disipline më të përgjithshme për këtë çështje referuar paragrafit të tretë të nenit 98 të Kushtetutës, dhe jo më vonë se një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, punonjësit e policisë sipas nenit 16 të ligjit aktual, nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike.

Neni 115. Mbulimi honorareve financiare

Sipas ligjit aktuale, është bërë vlerësimi për 205 miliard lira në vit, parashikuar për vitin financiar 1981

dhe që i korespondon reduktimit të kapitullit

6856 për shpenzimet nga Ministria e Thesarit për vitin financiar në 200 miliard, zbritja me pesë miliard është bërë sipas “Rishikimit të trajtimit ekonomik të nënpunësve publik”.

Ministri Thesarit është i autorizuar të nxjerrë dekretet përkatës për ndryshimet e bilancit.

Tabela shpjeguese e gradave dhe kualifikimeve

Grada dhe tituj sipas urdhrorit të parë të Trupave të Gardës së PSh dhe femrave në polici dhe funksionarët civil të PSh	Titulli sipas urdhrorit të Policisë së Shtetit	Gradat e personelit dhe forcave të tjera të policisë
Garda e P.S	Agjenti 1	Karabinier
Garda e zgjedhur	Agjenti 2	Karabinier i zgjedhur
I e emeruar . . .	Asistent fillestar Asistent 2	I emeruar I emeruar me mbi 24 vjet shërbim apo 10 vjet vjetërsi ne grade
Nenbrigadier	Superintendent fillestar	Nenbrigadier
Brigadier	Superintendent 2....	Brigadier
Marshall i klases se trete	Superintendent 3	Marshall i thjeshte
Marshall i klases se dyte		Kryemareshall
Marshall i klases se pare	Superintendent final	Marshall madhor
Marshall i zgjedhur i		Marshall madhor adjutant

klases se pare		
Komisar – inspektore e policise femerore (niveli VII, neni 4 ligji 11 korrik 1980, nr 312	Komisar 1	Toger
Komisar kryeinspektore e policise e larte (Niveli VII me me shume se kater vjet e gjysme sherbimi)	Komisar 2	Kapiten
	Komisar 3	Major
Nenkuestor asistent – Inspektore kryeasistente (niveli VIII me te pakten 9 vjete e gjysme sherbimi)	Komisar 4	Nenkolonel
Drejtues i pare epror i PSh	Drejtues i Pare	Kolonel
Drejtues epror i PSh	Drejtues i larte	Gjeneral Brigade
Drejtues i pergjithshem i PSh	Drejtues i pergjithshem	Gjeneral divizioni

Në tabelë nuk janë përfshirë titulli për inspektor, në lidhje me ekuivalentimin me grada dhe tituj sipas urdhrit të mëparshëm të PSh dhe as gradat e personelit dhe forcave të tjera të policisë. Përsa i përket asistentëve femra në polici, ëshë si në vijim të nenit 33:

Asistente (niveli VI deri në 8 vjet shërbim): titulli i 3-te në rol inspektor;

Asistenti parë (niveli VI, fino a 3 anni di servizio): titulli i 3-te në rolin inspektor;

kryeasistent (niveli VII, me të paktën 13 vjet shërbim): titulli i 4-t për rolin inspektor